



USHTRIA



Viti i 69-të i botimit Nr. 33 (82634)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 21 gusht 2015

TAKIM MBI ANGAZHIMIN E FA PËR PËRBALLIMIN E EMERGJENCEVE CIVILE GJATË VITIT 2015



Zv/ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo, zhvilluan në ambientet e Komandës Mbështetëse një takim informues mbi punën dhe angazhimet e strukturave të Forcave të Armatosura për përballimin e emergjencave civile gjatë vitit 2015. Në këtë takim ishin të pranishëm pjesëmarrës nga të gjitha forcat si, Forca Tokësore, Forca Ajrore, Forca Detare, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes,

Policia Ushtarake, Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes e Informacionit, Batalioni i Mbështetjes në SHP, si dhe strukturat e Komandës Mbështetëse në rolin organizator të këtij takimi. Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ylber Dogjani, i cili pasi i uroi zv/ministrit të Mbrojtjes Koçi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bazos, mirëseardhjen në këtë komandë...

» faqe 2

Konfliktet aktuale të luftës hibride-çështje të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen tonë»

» faqe 6-7

RESOLUTE SUPPORT

N/kolonele Bardha Pali rrëfen ditët e para të saj në mision

NATO OTAN		Resolute Support Mission	
Troop Contributing Nations			
	Albania		Germany
	Armenia		Greece
	Australia		Hungary
	Austria		Iceland
	Azerbaijan		Ireland
	Belgium		Italy
	Bosnia-Herzegovina		Latvia
	Bulgaria		Lithuania
	Croatia		Luxembourg
	Czech Republic		Mongolia
	Denmark		Montenegro
	Estonia		Netherlands
	Finland		New Zealand
	Georgia		Norway



» faqe 8-9

Forca Detare

Shërbimi Hidrografik Shqiptar, arritje dhe përgjegjësi në realizimin e detyrave të ditës

Shërbimi ynë Hidrografik është një komponent i rëndësishëm i Forcës sonë Detare, sepse luan rol parësor në sigurimin e kushteve hidrolundimore dhe sinjalistikës detare për lundrim të parrezikshëm të mjeteve detare në hapësirën ujore të Republikës së Shqipërisë...

» faqe 3



Reportazh

Një verë plot aktivitete për pushuesit e Shtëpive të Ushtarakëve

Vera është stina e preferuar e pjesës më të madhe të njerëzve, pa pasur diferenca moshore, profesionale apo sociale. Ajo i grish njerëzit në mënyrë të veçantë me magjinë e detit, banjat e diellit, ushtrimin e sportit të bukur të notit që jo vetëm e mban...

» faqe 4-5



HISTORI

Pjesëmarrja e luftëtarëve nga vendi në Luftën e Vlorës 1920

» faqe 14-15

NATO

Histori treguar përmes posterave

» faqe 10

NEDIM GJONI

Veterani i Luftës dhe një nga themeluesit e Artilerisë Kundërajrore

» faqe 13



Takim mbi angazhimin e FA për përballimin e emergjencave civile gjatë vitit 2015

Zv/ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo, zhvilluan në ambientet e Komandës Mbështetëse një takim informues mbi punën dhe angazhimet e strukturave të Forcave të Armatosura për përballimin e emergjencave civile gjatë vitit 2015. Në këtë takim ishin të pranishëm pjesëmarrës nga të gjitha forcat si, Forca Tokësore, Forca Ajrore, Forca Detare, Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes, Policia Ushtarake, Agjencia e Sistemeve të Ndërlidhjes e Informacionit, Batalioni i Mbështetjes në SHP, si dhe strukturat e Komandës Mbështetëse në rolin organizator të këtij takimi.

Fjalën e hapjes e mbajti komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ylber Dogjani, i cili pasi i uroi zv/ministrit të Mbrojtjes Koçi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bazos, mirëseardhjen në këtë komandë, informoi mbi punën e bërë nga strukturat e Forcave të Armatosura për përballimin e emergjencave civile gjatë vitit 2015. Më pas ai theksoi se strukturat e FA ndoqën me vëmendje situatat e krijuara dhe vendosën në gatishmëri të gjitha asetet e deklaruara në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile, për t'ju ardhur në ndihmë banorëve të rrezikuar nga fatkeqësitë natyrore. Në mbështetje të kërkesave të shtabeve të EC të ngritura për përballimin e situatës së krijuar nga rreshjet e shiut në Jug të vendit, si dhe temperaturat tepër të larta gjatë muajit korrik-gusht strukturat e FA u angazhuan në disa operacione, duke dhënë një kontribut të madh në përballimin e këtyre fatkeqësive. Më konkretisht strukturat e FA janë angazhuar:

- Në operacione të kërkim – shpëtimi për evakuimin e 243 banorëve gjatë përmbytjeve në jug;
- Në operacioni SAR në Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës;

- Në zhblokimin nga inertet në disa akse rrugore;
- Në transportim dhe shpërndarjen e ndihmave ushqimore për popullsinë dhe bazës ushqimore për bagëtinë;
- Për forcimin e argjinaturave në Lagunën e Nartës dhe urën e Mifolit;
- Për uljen e nivelit të ujit në ujëmbledhësin e Manskurisë në Golem, Kavajë;
- Për shuarjen e vatrave të zjarrit në disa zona të vendit si, në fshatin Kaçi-

nar, Balldren, Kakariq dhe Shëngjin të Qarkut të Lezhës. Në fshatin Shikaj të Qarkut të Kukësit, në fshatin Krastë të Qarkut të Durrësit, në fshatin Tërnovë të Qarkut të Dibrës, në fshatin Melgushë të Qarkut të Shkodër, në fshatin Poshnjë të Qarkut të Berat, si dhe në fshatin Cakran të Qarkut të Fier.

Për realizimin e këtyre operacioneve FA kanë angazhuar 720 trupa, 90 mjete transporti, 2 qendra mobile, 1 ambulancë, 5 zjarrfikëse, 6 motorbarka,

12 gomone, si dhe 11 motopompa thithëse.

Në mënyrë më të detajuar për realizimin e këtyre operacioneve informuan përfaqësuesit e të gjitha komandave të Forcave. Në përfundim të prezantimit nga të gjithë përfaqësuesit fjalën e mori shefi i Shtabit të përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Ai falenderoi të gjithë të pranishmit dhe vlerësoi punën e bërë nga strukturat e FA në përballimin e EC gjatë gjithë vitit

“Organizimi i këtij takimi në pikun e emergjencave tregon më së miri se nënpunësit e shtetit mund të jenë pushim, por jo vetë shteti”.

2015. Ai citoi se tashmë FA disponon asetet e nevojshme për përballimin e EC e deri në emergjencat teknologjike. Bashkëpunimi dhe koordinimi midis strukturave në FA ka qënë në nivelin e duhur, çka tregon dhe profesionalizmin e demonstruar gjatë gjithë situatave.

Më pas fjalën e mori zv/ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, i cili shprehu pa mëdyshje arritjet dhe rezultatet që FA kanë treguar në përballimin e EC. Gjithashtu zv/ministri theksoi se organizimi i këtij takimi në pikun e emergjencave tregon më së miri se nënpunësit e shtetit mund të jenë pushim, por jo vetë shteti. Në fjalën e tij ai gjithashtu shprehu bindjen se edhe në të ardhmen FA do të vazhdojnë të tregojnë profesionalizëm dhe një mbështetje gjithpërfshirëse të komunitetit. Në përfundim të fjalës së tij, zoti Koçi përcolli dhe mesazhin e ministrit të Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli për të gjithë FA të angazhuara në këto operacione në ndihmë të komunitetit.

Rreshter Bledar Blacëri

Shërbimi Hidrografik Shqiptar, arritje dhe përgjegjësi në realizimin e detyrave të ditës

Shërbimi ynë Hidrografik është një komponent i rëndësishëm i Forcës sonë Detare, sepse luan rol parësor në sigurimin e kushteve hidrolundrimore dhe sinjalistikës detare për lundrim të parrezikshëm të mjeteve detare në hapësirën ujore të Republikës së Shqipërisë. Ai është një nga asetet dhe repartet prioritare të Forcës Detare jo vetëm për misionin dhe detyrat që ka, por dhe për faktin se misioni i tij i kalon caqet e detyrave thjesht ushtarake në det, pasi ka dhe një rol të rëndësishëm në transportin detar civil të vendit. Kuadrot dhe specialistët e këtij shërbimi i gjen kurdoherë në krye të detyrës. Dhe në këto ditë të nxehta vere ata kanë realizuar disa detyra të rëndësishme për sigurimin hidrolundrimor të gjitha mjeteve detare në sezonin turistik. Komandanti i Shërbimit Hidrografik Shqiptar, Kapiten i Rangut të II-të Lulzim Kryeziu na informon se puna e kuadrove dhe specialistëve të tij gjatë kësaj periudhe është përqëndruar në dy drejtime, së pari, mbështetja e anijeve të Forcës Detare me botime dhe harta të nevojshme; së dyti, siguri i lundrimit të parrezikshëm të gjithë mjeteve detare në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet monitorimit permanent të sinjalistikës detare dhe sistemit të farofenerevë. Kështu në bashkëpunim me IGJU, duke shfrytëzuar matjet e bëra nga kolegët e këtij shërbimi të SHBA, Italisë dhe Anglisë u bë e mundur botimi i hartave të para, konkretisht Harta me nr.101, që përfshin rajonin Grykëderdhja e Bunës-Kepi i Lagjit dhe harta me nr.102, që përfshin rajonin Spille-Radhimë. Ndërkohë po punohet për përgatitjen e hartës me nr.103, Gjiri i Vlorës-Kepi i Stillos, e cila plotëson kështu gjithë vijën bregdetare të vendit tonë. Këto harta të shkallës 1 me 100 000, plotësojnë standartet e kërkuara të IHO, {Shërbimit Hidrografik Ndërkombëtar} dhe ndihmojnë detarët tanë për lundrim të përgjithshëm dhe lundrim bregdetar. Ky produkt i ri u përdor me sukses nga detarët e vendeve pjesëmarrëse në stërvitjen “AdriJon-2015”, thotë Kapiten Kryeziu. Perspektiva e kësaj pune shkencore është prodhimi i hartave dixhitale për të gjitha mjetet detare në bashkëpunim me Shërbimin Hidrografik Norvegjez që përfshihet dhe në projektin ALNO-HIP. Është një detyrim i vendit tonë për anëtarësim në IMO, {Organizata Detare Ndërkombëtare} që brenda vitit 2018, të gjitha anijet mbi 1500 t të jenë të pajisura me harta elektronike, afat të cilin ne do e përmbushim para kohe. Në fokusin e detyrave të specialistëve të këtij



shërbimi gjatë sezonit turistik ka qenë siguria hidrolundrimore dhe monitorimi i rajonit Gjiri i Vlorës-ishulli i Sazanit në kuadër të marrëveshjes për lejimin e turistëve në ishullin e Sazanit. Gjithashtu hidrografët tanë i

janë përgjegjës në kohë dëmtimeve të sinjalistikës detare si bova e fenerë, shkaktuar nga kapriciot e motit dhe kushtet atmosferike. Në afate optimale janë riparuar e zvendësuar fenerët hyrës në portin e Vlorës dhe të Durrësit. Për



këtë është bashkëpunuar me Autoritetet Portuale respektive por mjaft detyra po zgjidhen në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Brendshme, të Transportit dhe Bujqësisë. Realizimit në kohë të detyrave i ka shërbyer kualifikimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i kuadrove dhe specialistëve të këtij shërbimi ku kanë ndihmuar dhe partnerët tanë si SHBA, Norvegji, Angli, Itali, etj. Synimi final i këtij efektivit është arritja e standarteve dhe kapaciteteve të kërkuara nga IHO, {Organizata Ndërkombëtare

Hidrografike} dhe plotësimi i kushteve për anëtarësim me të drejta të plota në këtë organizatë. Në takimin e fundit të Komisionit Rajonal Hidrografik të Detit Mesdhe dhe Detit të Zi, drejtuesit e IHO, këshilluan që Shqipëria duhet të jetë pjesëmarrëse aktive në veprimtaritë e IHO, si ato rajonale dhe botërore. Sigurisht që për misionin dhe dobinë ekonomike që i sjell vendit, ky shërbim kërkon më tepër vëmendje dhe ndihmë nga shteti shqiptar në të ardhmen.

Shefqet Kërcelli

NJOFTIM

për të drejta studimi për oficerë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Qendra e Personel Rekrutimit kërkon të rekrutojë kandidatë për oficerë për hapjen e kursit të titullimit oficer në Akademinë e Forcave të Armatosura Tiranë, për muajin Tetor 2015, me pjesëmarrje të 20 (njëzet) kandidatëve, nga të cilët 6 (gjashtë) më të mirët do të ndjekin programin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pjesa tjetër do të vazhdojë programin në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR-së është deri në 31 Gusht 2015.

Kriteret e pranimit të kandidatëve, dokumentet për regjistrim, datat e testimit, si edhe tabelat me pikët i gjeni edhe në format elektronik në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes.(pdf).

Aplikanti e dorëzon dokumentacionin pranë Zyrës së Pranimit në QPR dhe njëkohësisht plotëson formularin me të dhënat personale si dhe e firmos atë (Aneksi A).



ETLEVA SMAÇI

Vera është stina e preferuar e pjesës më të madhe të njerëzve, pa pasur diferencën moshore, profesionale apo sociale. Ajo i grish njerëzit në mënyrë të veçantë me magjinë e detit, banjat e diellit, ushtrimin e sportit të bukur të notit që jo vetëm e mban trupin në formë, por mbi të gjitha të siguron një jetë të shëndetshme. Por vera nuk do të ishte aq e paharrueshme në kujtimet e secilit prej nesh nëse do të ishte vetëm kaq. Për shkak të pushimeve koha e lirë e verës, mbushet me një sërë veprimtarish kulturnore e artistike, që pasurojnë pushimet tona. Të tilla janë koncertet që mbushin sheshet e qyteteve bregdetare, por jo vetëm ato, kinematë verore, që së fundmi janë zëvendësuar me ekranet e mëdha që gjenden ngado herë me kontributin e bashkive, herë si investim i biznesit privat (bareve të ndryshme), shfaqjet e trupave teatrore që i ngrenë skenat pranë pistave të plazheve apo shtëpive të pushimit. E pikërisht duke menduar një pushues të tillë, edhe QKMBMSHPU që në fillim të stinës hartoi një program të veçantë për targetgrupin e pushuesve të Shtëpive të Pushimit të Ushtarakëve.

E djeshmja e Shtëpive të Pushimit të Ushtarakëve

Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve kanë një historik të hershëm. Ato u ndërtuan mbi bazën e modelit rus, si shumë gjëra të tjera që u huan vitet e para pas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazi –fashist, në ideimin dhe strukturimin e Ushtrisë Shqiptare. Krahas pushimeve me një kosto shumë të lirë, pothuajse të papërfillshme me ato që ofroreshin për pjesën tjetër të popullatës edhe gjatë diktaturës, këto Shtëpi Pushimi synonin të ruanin frymën e miqësisë e bashkëpunimit mes ushtarakëve. Në rrjetin e Shtëpive të Pushimit të Ushtarakëve që shtriheshin në Durrës, Jalë dhe Pogradec, ajo më e njohura dhe më e populluara ka qenë dhe vazhdon të ngelet e tillë, Shtëpia e Ushtarakëve në Durrës, e njohur ndryshe me emrin Kavalishenca. Në kujtimet e shumë ushtarakëve, fëmijëve të tyre, ajo ngelet oazi i një vere magjike, plot aktivitete, me hapësirat e gjelbëra, sipërfaqet e këndeve të lojërave me dorë si basketboll, voleyboll etj, me pistën e famshme të vallëzimit, që konkurronte denjësisht me Vollgën e Ilirinë, me kinemanë që i ngjante një amfiteatri të vogël, ku shfaqeshin filma shqiptarë e të huaj. Kurse Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve në Pogradec, njihet për traditën e saj të përsosur në gatim, por edhe për faktin se e vendosur buzët liqenit të Pogradecit ajo ofronte pushimet me një panoramë mahnitëse. E treta, por jo pak më e rëndësishmja ka qenë Shtëpia e Pushuesve të Ushtarakëve në Jalë. Për vetë pozicionin e saj strategjik për epokën në të cilën u ndërtua, Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve në Jalë, nuk ishte e destinuar të priste një fluks të madh pushuesish siç ndodhte në Durrës e Pogradec. Në popullatë, por edhe në rrethet e

Një verë plot aktivitete për pushuesit e Shtëpive të Ushtarakëve



Foto nga Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve, Jalë

vetë ushtarakëve ajo njihet më tepër si një vilë, e ngjashme me modelet e vilave të qeveritarëve komunistë në bllok, Durrës, apo edhe në Vlorë e Drilon. Pra që në fillimet e ndërtimit të saj, nën përkujdesjen e Anton Shetit, emrin e të cilit ajo mban sot, Vila e Jalës, u parazgjidh si një destinacion pushimi për ushtarakët e karrierës, me pozicione të larta drejtuese, dhe kjo përcaktoi edhe kapacitetin e saj të kufizuar, duke e konceptuar si një shtëpi pushimi elitare, ose njohur ndryshe sot si “zona Vip”. Këta karakteristikë ajo vazhdon ta ruajë edhe sot. Por në kohën kur u hodhën themelet e saja, në ndryshim nga Durrësi, apo Pogradeci, Jala ishte një plazh i virgjër, edhe për shkak të mungesës së infrastrukturës. Shfrytëzimi i kësaj shtëpie pushimi ka qenë pothuajse inekzistent deri në vitet 90-të, dhe vetëm atëherë kur turizmi shqiptar njohu bumin e tij për shkak të zbulimit të këtyre perlave të Jugut, nevoja e shtimit të kapaciteteve të Shtëpisë së Pushimit Jalë u bë tepër e ndjeshme. Sot ajo ngelet padyshim një ndër asetet më me vlerë të Ministrisë Mbrojtjes, me turin panormaik që ofron. E ngritur mbi atë që sipas historisë njihet si Kodra e Asqerit, në një ditë me diell, kur qielli është i pastër nga retë, me sy të lirë, nga ballkonet e ndërtesave apo nga tavolinat e vendosura në oborrin e saj,

sheh Korfuzin së bashku me tri ishuj të tjerë. Por në kushtet e një turizmi që ka pësuar gjithmonë e më shumë një rritje të përvitshme çmimesh në hoteleri, Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve në Jalë është një zgjedhje unike. Sigurisht ky është një fat i ushtarakëve.

Mbrëmbjete muzikore që gjallërojnë pushuesit

Jo të gjithë pushojnë në verë. E pikërisht “këtë fat” e ka Sektori i Aktiviteve të QKMBMSHU, që drejtohet me një përkushtim të jashtëzakonshëm, e me një ndjenjë

vullnetarizmi që vlen të admirohet e të merret për shembull, nga një emër legjendë në sportin shqiptar, basketbollisti Gazmend Çaçi. Veprimtaria e këtij sektori përgjatë gjithë vitit është shumë e gjerë, sidomos në funksion të edukimit kulturor e sportiv të fëmijëve të ushtarakëve, por gjatë verës, ata që evidentohen më tepër janë artistët e skenës shqiptarë, këngëtarët Kozma Dushi e Redon Makashi. Koncertet e tyre janë në një interval kohor prej 10 ditësh, çka do të thotë, se çdo grup pushuesish, qoftë në Durrës, qoftë në Jalë, të paktën një natë kanë mundësinë e ndjekjes së një programi muzikor.

Krahas specialistëve të muzikës që QKMBMSHPU në këto aktivitete janë ftuar në mënyrë shoqërore, edhe artistë të tjerë qoftë të rinj si në rastin e njërës prej finalisteve të X Factor, Antonela Tekiçixhi, ashtu dhe artistë me eksperiencë si kompozitori Todi Dori, që ju jep këtyre mbrëmjeve një atmosferë të veçantë me muzikën klasike të luajtur në fizarmonikë. Edhe pjesët humoristike plot të qeshura e batuta të sjella nga aktori i mirënjohur komik Xhevahir Zeneli, nuk kanë munguar në programin veror për pushuesit. Kjo ka bërë që mbrëmjet artistike jo vetëm të pëlqehen nga ta, por në shumë raste të bëhen në mënyrë të natyrshme edhe vetë interpretë në këngë, valle e parodi.

Mbrëmja e Durrësit

Të përgatitësh një koncert që zakonisht zgjat 3-4 orë padyshim kërkon profesionalizëm të lartë. Po ky element nuk ju mungon artistëve tanë. Numri i madh i pushuesve në Shtëpinë e Pushimit të Ushtarakëve në Durrës, por edhe afërsia me Tiranën, krijon më tepër mundësi, për ta bërësa më të veçantë këtë festë. Këngëtarët ja lënë radhën njëri-tjetrit, e gjata pauzave të tyre, muzika popullore instrumentale bënë që pushuesit të vërshojnë si një rrjedhë e gëzuar dhe ta ngrenë peshë gjithë territorin e tyre. Në vallet nuk ka dallime, aty janë të vegjël e të mëdhenj, të gjithë bashkë duke rrahur fort këmbët në pistë, me lëvizjet tipike plot ojna të valleve shqiptare. Një moment ky magjik, që i fiksoi në foto, të bënë të kuptosh se kënga e vallja janë pjesë e pandarë e jetës sonë. Pa to nuk bëjmë dot. Mbrëmjet artistike të zhvilluara në Shtëpinë e Ushtarakëve të Durrësit, gjatë kësaj vere, kanë



Foto nga Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve, Durrës



qenë plot me surpriza, sidomos për pushesit e vegjël. Një e tillë ka qenë bërja pjesë e shfaqjeve e Cirkut të Tiranës. Numrat e interpretuar prej tyre, kanë emocionuar së tepërmi pushuesit dhe i kanë bërë të duartrokasin gjatë. Prania e artistëve të Cirkut të Tiranës, është padyshim një arritje dhe sukses i punës së palodhur të Sektorit të Aktivitetit, që pavarësisht mundësive shumë të limituara financiare, ka sjellë elemente jashtë insitucionit për të pasuruar jetën artistike në Shtëpitë e Pushimit të Ushtarakëve. Për këta artistë vëmendja duhet të jetë më e madhe, si për akomodimin e tyre, ashtu edhe për vlerësimin material. Edhe larmia e aktiviteteve duhet të jetë më e pasur, duke aktivizuar specialistët e arteve të tjera, si p.sh., ata të arteve figurative përmes hapjes së ekspozitave të ndryshme me motive nga jeta e ushtarakëve etj. Një tjetër

mundësi shumë me interes do të ishte dhe shfaqja e filmave dokumentarë të realizuar nga punonjësit e Sektorit të Audovizionit, që pasqyrojnë rrugëtimin e Ushtrisë Shqiptare.

Në Jalë

Shfaqjet në Jalë i ngjajnë një podium të ngritur mbi det. Ndonëse sipërfaqja ku zhvillohen shfaqjet është shumë më e kufizua se ajo në Durrës, po ashtu edhe numri i pushuesve, entuziazmi është po aq i madh. Drejtori i Shtëpisë së Pushimit të Jalës, Medi Zholi, një ushtarak karriere, e njeh mirë traditën e hershme të shtëpive të pushimit të ushtarakëve, prandaj ai jo vetëm këmbëngul për praninë e artistëve në çdo tur pushuesish, por krijon edhe të gjitha mundësitë për një mikpritje e akomodim bujarë të tyre. Pyet për çdo detaj të koncertit dhe nuk harron të japë edhe sugjerimet



e tij, pasi duke njohur gjeografinë e pushuesve dëshiron që shfaqja të jetë pjesë e shijeve të tyre. Koncerti i Jalës mund të quhet padyshim një koncert thellësisht patriotik, i përshkruar nga një fill i dëshirës, për ta parë Shqipërinë e Kosovën, si një shtet, pasi janë një komb. Midis spektatorëve të këtij koncerti, gjendet edhe ministri i Mbrotjes së Kosovës, që ndjek plot admirim, këngëtarin Kozma Dushi, të këndojë plot emocion “Xhamadanin vija- vija”, apo “Rrjedh në këngë e ligjërimë”. Atmosfera ndizet nën motivet popullore, ku krahinat vijnë e bëhen një nga Çamëria, në Dardani, aty në kërthizën e Labërisë. Nuk mungon as isoja labe, që vjen përmes këngëve të të madhit Lefter Çipa, me “Vajzë e valëve”. Kaq të bukura janë këngët tona, sa edhe deti hesht murrërimën e tij dhe i mban vesh. Edhe pishat e lashta që ngrihen në oborr nuk fëshfërijnë më. Dëgjohet vetëm kënga që pushton gjithçka. Kulmi i festës arrin kur të gjithë këndojnë si një kor i madh së bashku. Dhe këto koncerte nuk janë një apo dy orë, por ato zgjatin deri në 3-4 orë. Kur mesnata arrin kulmin e saj, të parët që fillojnë e dorëzohen janë vogëlushët që përgjumen në prehërin e nënave, por që këmbëngulin të qëndrojnë akoma. Hajdeni prap është shprehja më e dëgjueshme në raste të tilla, kurse artistët i urojnë sipas traditës popullore “të lumtë goja”. Mbyllet kështu një për mbrëmjeve të Jalës, kësaj perle të bregdetit shqiptar, ku ushtarakët e Forcave të Armatosura, pushojnë familjarisht, për t’u rikthyer plot energji në krye të detyrës, në mbrojtje të atdheut.

Turizmi arkeologjik dhe historik në Durrës, Jalë e Pogradec

Nëse një ushtarak apo një punonjës civil ka zgjedhur të pushojë në një ndër Shtëpitë e Ushtarakëve (aktualisht ajo e Pogradecit vazhdon të jetë jashtë funksionit), mundësitë e aktiviteteve kulturore në lëmin e arkeologjisë e historisë janë të pafundme. Qyteti i Durrësit e ka zonën muzeale jo më larg se 20 minuta nga Kavajë, apo ajo që njihet ndryshe si zona e Plepave. Mbasditet shumë mirë mund të shfrytëzohen për të vizituar amfiteatrin e famshëm të qytetit, me arenën gjigande ku zhvilloheshin ndeshjet e gladiatorëve, ushtarakëve të antikitetit, ose mund të zgjidhet të vizitohet Muzeu Arkeologjik i Qytetit. Torrrja Veneciane është një tjetër dëshmi e të shkuarës së Dyrrahut, kësaj

pike të Ilirsë së Hershme dhe Mesjetës. Për të ardhur te pjesët më të reja të historisë, busti i Mujo Ulqinakut, ushtarakut shqiptarë që priti me armë pushtuesit italianë. Janë të pafundme objektet që mund të vizitosh në Durrës, për t’u përmbyllur me vizitën e statuetave të këngëtarëve të mëdhenj të rokut, Tina Turner e Mick Jagger. Durrësi nuk ofron thjesht një shtëpi pushimi, por një pafundësi zbatimësh. E njëjta panoramë vlen edhe për Jalën. Pasuria arkeologjike që ofron bregdeti shqiptar është unike. Po e njëjta gjë vlen edhe për rrënojat historike. Jo më larg se 7 km nga Jala ndodhet Kalaja e Himarës. Një kala e famshme për qëndruesin e burrave të saj. Qëndresë e trashëguar në breza, që pasqyrohet me monumentet e Luftës Antifashiste NacionalÇlirimtare. Një i tillë është lapidari buzë detit që përkus-



jton krijimin e Çetës Antifashiste të Bregdetit. Një tjetër kala që nuk duhet të lihet pa u vizituar nga pushuesit i Shtëpisë së Pushuesve të Ushtarakëve në Jalë, është ajo e Ali Pashës në Porto Palermo. Ajo paraqet një interes të veçantë si një fortifikim ushtarak së pari, por edhe për rrëfenjën shumë të bukur historike të ndërtimit të saj. Kurse për fëmijët e tyre, që e njohin fare pak ose aspak historinë e ushtrisë shqiptare gjatë komunizmit, interes paraqet vizita në ish bazën ushtarake të ngritur gjatë Luftës së Ftohtë, pas prishjes me rusët, për nëndetëset dhe katërsiluruesit në gjirin e Porto Palermos. Ndërsa për ata që kërkojnë bukurie natyrore ato janë të pafundme, sa një 10 ditësh duket i pamjaftueshëm për t’i prekur. Në plazhin privat të Shtëpisë së Pushimit të Ushtarakëve Jalë, qëndron gjithmonë i ankoruar

në gjendje gadishmërie motoskafi i Forcave të Ndërhijës së Shpejtë. Sapo marrin detyrën ata nisen me shpejtësi duke çarë detin. Jo në pak raste ata janë guidë e pushuesve ushtarakë në gjiret e virgjëra rreth Jalës, që arrihen me vështirësi me këmbë, siç është gjiri i Gjipesë, apo Shpella e Piratëve.

E ardhmja e Shtëpive të Pushimit të Ushtarakëve

Të lëna për shumë vite në harresë, dy vitet e fundit ju kanë kthyer identitetin Shtëpive të Pushimit të Ushtarakëve. Të përdorura pa kriter, shpeshër duke ju tjetërsuar edhe funksionet ato kanë rreshtur së qeni në shërbim të Forcave të Armatosura dhe pothuajse nuk kanë pasur asnjë lloj veprimtarie social –kulturore. Përmirësimi i ndjeshëm edhe në

infrastrukturë e shërbim, ka bërë që sot ato të konkurrojnë denjësisht në tregun e hotelierisë dhe tuzimit vendas. Krijimi i një atmosfere me të vërtetë zbatimëse përmes një jete të gjallë kulturore dhe sportive ngelet sfida e radhës, pasi faza e plotësimit të nevojave utilitare me kushtet e nevojshme të banimit dhe pushimit është tejkaluar. Për këtëjo vetëm që duhet të planifikohen buxhetet në kohën e duhur, por edhe projektet artistike e sportive nuk duhet t’i lihen spontanitetit të pushimeve. Pushuesit e kulturuar janë një pasuri për to, por edhe tregues të një standarti të lartë në fushën e turizmit. Sa më shumë koncerte, sa më shumë aktivitete aq më të bukura do jenë çastet që do të pasurojnë jetën e ushtarakëve dhe familjeve të tyre përgjatë sezonit të verës.

ASPEKTE STUDIMORE PËR SIGURINË

Konfliktet aktuale të luftës hibride-çështje të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen tonë



NËN/KOL (R) MSC KANAN HIMAJ
Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit

Konfliktet aktuale janë mjaft komplekse, dinamike dhe të paparashikueshme. Zhvillimi i teknikave dhe mjeteve të luftës kanë sfida të reja për forcat ushtarake, për të cilat ata duhet të jenë të përgatitur. Lufta hibride është një kornizë konceptuale më e gjerë se sa mënyrat e ndryshme të përdorimit të aseteve ushtarake dhe mjeteve të tjera si armë të drejtpërdrejta. Natyrshëm që këto çështje janë të vlefshme edhe për aspektet e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit tonë. Në ditët e sotme jemi në epokën e kompleksitetit të madh dhe ndërvarësisë jo vetëm në luftë, por edhe në jetën politike, shoqërore dhe private të çdo njeri prej nesh. Ky kompleksitet është lehtësuar nga përhapja e teknologjive të reja duke përhapur informacion në kohë reale. Ky kompleksitet nuk ndikon vetëm në mjedisin e sigurisë, por është një pjesë integrale e saj. Ai ndikon dhe po ndryshon tërë filozofinë e luftës.

Një koncept përkufizues i luftës hibride

Ka shumë përkufizime të luftës hibride dhe të terrorizmit. Përkufizimet për luftën hibride janë që nga viti 2008-2010, por ato janë tashmë të vjetëruara. Nga pikëpamja teorike, fillimisht ishin luftëra të vogla, pastaj flitet për konflikt me intensitet të ulët apo të lehtë, më pas luftë e parregullt dhe asimetrike dhe në fund u shfaq lufta hibride. Sipas një raporti mbi terrorizmin, kërcënimet jo konvencionale në SHBA, shtator 2010, "lufta hibride mund të përdoret në mënyrë joformale për të përshkruar ndryshimin e pandërprerë të kompleksitetit dhe dinamikën e betejës", por nuk ka asnjë përkufizim zyrtar dhe nuk ka plane për ta bërë këtë, duke pretenduar se doktrinat ekzistuese për luftë tradicionale dhe të parregullt janë të mjaftueshme për të përshkruar mjedisin



operacional aktual dhe të ardhshëm.

Zyrtarë të lartë ushtarakë amerikanë kanë thënë në mënyrë të përsëritur se Shtetet e Bashkuara kanë taktika kundërshtarë të praktikës së "luftës hibride", të cilat do të përfshijnë sulme ndaj rrjeteve kompjuterike dhe forma të tjera të teknologjisë, zakonisht të njohura si sulmet në internet ose lufta kibernetike. Auditimi i kryer në vitin 2010 ka gjetur se, gjatë periudhës 2008-2010, zyrtarët ushtarakë amerikanë e kanë përdorur "luftën hibride" për të karakterizuar metodat e luftës së përdorur nga kundërshtarët amerikanë në Irak dhe Afganistan. Termi është përdorur për të përshkruar jo vetëm sulmet kibernetike, por gjithashtu sulmet me armë biologjike, nukleare, radiologjike dhe kimike; pajisje të improvizuara eksplozive dhe manipulim i informacionit dhe medias, në mes të formave të tjera të sulmit. "Lufta hibride" është përzierja e metodave konvencionale dhe të pa rregullta në të gjithë spektrin e plotë të konfliktit. Qendra Amerikane për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare ka përcaktuar se lufta hibride përfshin katër kërcënime: (1) ato tradicionale; (2) e parregullt; (3) terrorizmin; dhe (4) veprimtarinë përçarëse, të cilat shfrytëzojnë teknologjinë për të luftuar superioritetin ushtarak.

Përcaktimet e përmendura tregojnë qasje të pastër ushtarake të luftës

hibride. Ato përqendrohen në fushën e betejës dhe të aftësive ushtarake për të vepruar në mjedisin bashkëkohor të sigurisë. Deri në njëfarë mase ato përbëjnë një zhvillim të koncepteve të konfliktit asimetrik dhe luftës së parregullt.

Karakteristikat e përbashkëta të konflikteve aktuale

Informacioni i suksesshëm dhe fushata propagandistike e bërë në dy

drejtime në nivel ndërkombëtar dhe tek audiencat e synuara të zgjedhura për vite me radhë, duke arritur dominimin në sferën e informacionit si minimum për audiencat e synuara dhe mbi rajonet/ territoret e zgjedhura. ISIL bën përpjekje të veçanta në fushatën e tyre në popujt arabë dhe myslimanë. Rusia bën përpjekje të veçanta për popullsinë sllave dhe ish-satelitët e Bashkimit

Sovjetik, ku ndikimi rus është ende shumë e fortë.

Ekonomia e dobët krijon hapësirë e duhur për të kryer veprime dhe për të sjellë rezultate të qëllimshme të agresorit / anën aktive;

Sektori financiar dhe bankar janë pika dominuese që godasin ekonominë dhe sistemin bankar duke e sjellë në prag të kolapsit;

Problemet në jetën sociale dhe ekonomike të cilat sjellin mosbindje civile dhe trazira të përdorura si pretekst për kryengritje dhe lëvizje politike;

Shtet i dështuar (Iraku dhe Siria), ose qeveria e dobët qendrore (Ukrainë), në bazë të karakteristikave të përmendura më sipër, të cilët kanë humbur





kontrollin mbi pjesë të territorit apo në rajon të veçantë si një parakusht për konflikt.

Mbështetje nga popullsia lokale... mbi bazën e frikës nga krahu ushtarak i agresorit / kryengritjes. Ka disa mendime se mbështetja nga popullsia lokale është vullnetare. Në rastin e ISIL-it ajo është e dukshme edhe në nivel ndërkombëtar. Për rastin e Rusisë tregojmë thënien e një gazete bullgare, e cila tregon pothuajse të gjitha lidhjet me ndjenjat në vendet ish-satelitë të Bashkimit Sovjetik "...sa më shumë i paturp, arrogant midis nesh maskon frikën e skllavit në formën e mirënjohjes për çlirimtarin".

Prania e pakicës etnike / fetare e cila

është përdorur si një arsye themelore për konfliktin dhe për të zgjeruar mbështetjen formale të popullsisë lokale.

Disa simbole unike shumë të njohur dhe lehtësisht të dallueshëm nga popullata dhe ndërkombëtarisht - Filozofia e ISIL-it është mirë përfaqësuar nga simbolizmi në variantin Standard i flamurit të Zi si legjendë të betejash të Muhamedit dhe e adoptuar prej tyre. Kostumi portokalli i burgut për jobesimtarët që u priten kokat. Simbol i fuqisë ruse - "njerëz të vegjël të gjelbër"/little green men në pjesën lindore të Ukrainës, tregues të njohur nga popullata lokale si ushtarë të forcave të rregullta të armatosura ruse.

dimore të ndikuar nga myslimanizmi radikal dhe propaganda e ISIL-it. Për krizën në Ukrainë njerëzit janë separatistët lokalë dhe forcat e armatosura ruse.

- Burimet e vazhdueshme dhe të qëndrueshme për financimin e aktiviteteve rebele / separatiste / kryengritëse.

Dimensionet e reja të luftës hibride, pjesë e strategjisë reaguese për ne

Lufta hibride kërkon një angazhim të fortë dhe afatgjatë dhe aftësi në fusha të ndryshme të tilla si në atë të informacionit, financiare, sociale, ekonomike, fetare / etnike dhe së fundi në ushtri. Është e nevojshme që fuqia që përdor metoda hibride të ketë ndikim të madh ndërkombëtar dhe sistem të fortë të unifikuar politik që mund të lejojë që ajo të ndjekë një strategji strikte afatgjatë, jo më pak se një dekadë. Zakonisht kundërshtari / pala pasive duhet të jetë më e dobët se agresori / pala aktive. Së pari, kushtet e nevojshme që kërkohen duhet të përbëhen nga informacioni i jetës ekonomike dhe sociale të kundërshtarit / palës pasive. Më tej është koha për zgjerimin dhe përdorimin e forcës ushtarake për të marrë kontrollin mbi territoret, ndërkohë ndodh lëvizja politike duke deklaruar pretendime politike dhe territoriale.

Luftë Hibrid nuk është një strategji apo koncept ushtarak. Lufta hibride është informacion kompleks, qasja sociale, ekonomike, politike dhe ushtarake për të pushtuar një vend. Si

KONCEPTE TE "LUFTES HIBRIDE"

“Lufta hibride” është përzierja e metodave konvencionale dhe të pa rregullta në të gjithë spektrin e plotë të konfliktit. Qendra Amerikane për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare ka përcaktuar se lufta hibride përfshin katër kërcënime: (1) ato tradicionale; (2) e parregullt; (3) terrorizmin; dhe (4) veprimtarinë përçarëse, të cilat shfrytëzojnë teknologjinë për të luftuar superioritetin ushtarak.

- Burimet për rekrutimin e personelit. Për ISIL këta janë të gjithë rebelë dhe grupe kryengritëse në Lindjen e Mesme dhe individë në vende perën-

pjesë e luftës në sferën e informacionit janë të gjitha veprimet në hapësirën kibernetike, sepse thelbi i hapësirës ekzistuese kibernetike ka të bëjë me të dhëna.

Lufta hibride përmban përpjekje të koordinuara graduale afatgjata të rritura dhe të zgjeruara në fusha të ndryshme të tilla si informacioni; ekonomike; sociale me fokus të veçantë në karakteristikat etno-fetare; politike; dhe në fund ushtarake. Ajo duhet të bëhet në bazë të një, strategjie të fortë komplekse unike të unifikuar duke synuar efekte sinergjike. Lufta hibride përfshin efektet e arritura në sferën e informacionit, atë sociale, ekonomik dhe në fund për përdorimin bazë të tyre të mjeteve politike dhe ushtarake.

Të gjitha veprimet në sfera të ndryshme janë të lidhura, të ndërlidhura dhe të mbivendosura me sfera të ndryshme të drejtuara nga një strategji afat-gjatë. Megjithatë ekziston një rend logjik. Veprimet fillojnë në sferën e informacionit, më pas vazhdojnë në sferën ekonomiko-financiare dhe so-

cialë në të njëjtën kohë. Kur veprimet në sferat e përmendura përbëjnë kushte të përshtatshme është koha për ushtrinë.

Politika parandaluese e NATO-s në reagimin mbi konfliktet në rritje (lufta hibride) fokusohet në kundërpërgjigjen e shpejtë ushtarake. Kjo politikë ka disa dobësi të mundshme.

Së pari: shtetet anëtare mund ta kenë të vështirë të bien dakord mbi burimin e konfliktit dhe në lidhje me veprimet e duhura kolektive.

Së dyti: për të luftuar kërcënimet hibride, vetëm fuqia ushtarake është e pamjaftueshme. Pavarësisht se sa e shpejtë dhe masive mund të jetë kundërpërgjigja, dislokimi i forcave ushtarake në një zonë të përfshirë nga lufta hibrid do të rezultojë në “tepër pak, tepër vonë”. Shumë shpesh, konflikti arrin nën nivelet kritike në lidhje me treguesit e vendosur për monitorimin, “nën radar”.

Së fundi, një luftë e ndërtuar vetëm mbi forca ushtarake nuk do të jetë e besueshme, pasi ajo evoluon në sferat informative, sociale, ekonomike, politike dhe ushtarake në jetën e vendeve të prekura.

Reagimi ndaj luftës hibride kërkon një strategji të qëndrueshme, stabël dhe të përhershme afatgjatë. Kjo strategji mund të arrihet nga çdo shtet i aleancës. Situata për Irakun në vitin 2003, tregon se sa e vështirë është nganjëherë që Shtetet Anëtare të arrijnë unitetin në çështje të caktuara.

NATO ka avantazhin e saj unik, që është informacioni, më saktë, aftësia për të mbledhur dhe përdorur informacionin. Mbi këtë bazë, ajo mund të informojnë në kohë shtetet anëtare të prekura, sepse reagimet në jetën sociale, ekonomike dhe financiare janë kryesisht përgjegjësi kombëtare.

Disa përfundime

Lufta hibride është praktikë e re dhe koncepti teorik e cila ka lindur si një qasje e unifikuar në antagonizëm, armiqësi që shkon përtej luftës, siç kemi konstatuar deri kohët e fundit. Perceptimi tradicional i luftës përfshin përplasje në sferën e informacionit, atë politike dhe ushtarake. Lufta hibride përfshin konfrontimin aktiv dhe të drejtpërdrejtë në sferat tjera të jetës publike të tilla si sociale, financiare dhe ekonomike, si pjesë e luftës.

Mjaft prej aspekteve të lartpërmendura janë parashikuar si sfida për ne në dokumentet kryesore të sigurisë dhe veçanërisht në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Natyrshëm që prej saj rrjedhin detyra direkt që përfshihen për FA në Strategjinë e re Ushtarake. Pavarësisht prej tyre angazhimi ndaj këtyre fenomeneve ka filluar prej vitesh ku janë bërë pjesë e skenarëve të sigurisë dhe mbrojtjes dhe pjesë e sistemit të planifikimit të mbrojtjes. Por, duhet të theksojmë që janë momentet e duhura të rishikojmë me kujdes shfaqet e huaja dhe të “trazuara”, të cilat përbejnë rrezik jo të vogël për shtetet dhe pse jo edhe për mbrojtjen tonë. Ne duhet të fokusohemi në strategjinë proaktive dhe vepruese, në radhë të parë në sferën e informacionit. Pjesa më e rëndësishme e kësaj është ndarja e informacionit sensitiv dhe të inteligjencës në mënyrë rigorozë duke ndjekur procedurat e



MBRESAT E NJË USHTARAKEJE NË MISION

Përfaqësimi i vajzave dhe grave ushtarake të FA në RS është nder dhe përgjegjësi

Nënkolonele **BARDHA PALI**
Strategic Advise in CAG,
HQ RS - Kabul

Nga Rinasi në Kabul

Misioni ynë për Afganistan nisi që me datën 10 korrik 2015, ora 15:15, kur avioni ynë u shkëput nga pista e Rinasit, në drejtim të Stambollit. Ishim një grup i vogël, jo ndoshta si misionet e tjera, por detyrat dhe qëllimet janë po aq serioze e të rëndësishme, përgjegjësitë po aq të mëdha ndaj vendit, ndaj aleancës NATO, ndaj uniformës së nderuar të FARSH. Ashtu siç është karakteristike për ushtarakët, të bërë bashkë si një trup i vetëm, edhe në përcjelljen e familjarëve, miqve ishim të gjithë tok. Edhe pse të gjithë jemi përballuar shpeshherë me ndarje me familjarët tanë, do të ishte jo fort e besueshme nëse do të thoshim, se nuk i ndihem lotët të na mblidheshin “në grykë”, kurse ata të familjarëve tanë nuk mundim t’i ndalnim dot. Nuk ishte në dorën tonë. Sidomos kur bëhej fjalë për ndonjë si unë që vajtjen në mision e kishte për herë të parë. E ndieva zërin të më tradhtëonte dhe sado përpiquesha ta kontrolloja duket se “disiplina ushtarake”, nuk e bëri dot zap emocionin njerëzor. Por ishte vetëm një çast, pasi sapo u vendosëm në sallën e pritjes, në pritje të lajmërimit për fluturim, ajo që më pushtoi të gjithën ishte ndjenja e të përgjegjësisë për detyrën që më priste së bashku me grupin ku bëja pjesë. Por deri në mbërritjen tonë në Kabul do të na duhej të përshkruanim një itinera, që për çdokënd tjetër do të ishte interesant në aspektin e udhëtimit, por jo për një ushtarak karriere, që udhëton drejt një vendi ku akoma paqja duket e largët. Qëndresa e parë ishte Stambolli. Një udhëtim që zgjati gati 2 orë e 15 minuta. Pothuajse gati 2 orë të tjera do të ishte qëndrimi, për fluturimin e radhës drejt Dubait. Aeroporti i Stambollit, ashtu si dhe vetë Stambolli është treguesi më i mirë i kryqëzimit të lindjes e perëndimit. Ai ka markën e të gjitha qytetërimeve dhe duket se kjo e bëri më të lehtë pritjen edhe për ne. Mund të them pa asnjë hezitim se në atë kohë të shkurtër pritjeje pata ndjesinë se para syve po më kalonin të gjitha ato çfarë kisha lexuar për Stambollin si një miks kulturash. Aeroportet ngelen vende interesante për të vëzhguar dhe kuptuar qytetërimet. Kështu ngjitëm shkallët e avionit për Dubai, çka e bënë këtë rrëfim të duket si një rrugëtim turistik me një theks të ndjeshëm ekzotik. Aq më shumë ma përforcoi këtë ide, vendi ku u ula në avion. E pozicionuar pranë dritares mund ta shihja qartë fare udhëtimin. Koha e mbërritjes në Dubai ishte në mbrëmje. Po dritat shumëngjyrëshe të tij, jo vetëm e bënin edhe më mad-



hështor, por të vështirësonin të kuptojë kufirin mes ditës e natës. Ndjenja e humorit, apo gjurmët e para të mallit që filluan të shfaqeshin, na bënë pak ëndërrimtar, aq sa edhe pse akoma nuk e kishim nisur misionin filluam të flisnim për kohën e përfundimit të tij. I premtuam njëri –tjetrit (ishim gjithësej 6 veta, mes tyre unë e vetmja grua dhe ndihem e nderuar më tepër se e privilegjuar për këtë fakt) se pushimet e

para pas misionit do t’i bënim pikërisht këtu në Dubai, i njohur për shkëlqimin e tij dhe turizmin elitare që ofron. Por me të vënë këmbët në aeroport teksa kërkonim portën e hyrjes (gate) për në Kabul, pata atë ndjesinë therëse se tani gjërat fillonin e bëheshin më të vështira, realiteti më i prekshëm se ai që kishim dëgjuar apo parë përmes edicioneve të lajmeve. Ashtu si kisha bërë një vëzhgim të shkurtër sociologjik në Stamboll

dhe më kishin parakaluar para syve Bizanti e Anatolia njëkohësisht, edhe këtu e ndjeva atë aromën e luftës që Afganistani i përcjellë botës prej shumë kohësh në stërmundimin që të nisë një jetë ndryshe. Për këtë përpjekje ishim nisur edhe prej Shqipërisë së largët si pjesë e Misionit Resolute Suport. Nuk e patëm të vështirë për të identifikuar faktin se shumica e pasagjerëve me të cilët do të udhëtonim drejt Kabulit ishin afganë. Veshja ishte shenja e parë e tyre dalluese. Vështrimin e ndala për pak çaste dhe jo në mënyrë direkte mbi gratë. Më erdhi në mendje një shkrim i lexuar disa kohë më parë mbi pozitën e grave afgane para se talibanët të merrnin vendin nën kontroll. “Once Upon a Time in Afghanistan” një ese e ilustruar me foto që dokumentonte se sa shumë kishte ndryshuar jeta dhe pozicioni social i grave në këtë vend. Dhe mendimet e mia nuk ishin aspak të rastësishme, ato lidheshin direkt me detyrën që më priste pranë Komandës Qendrore të Misionit Resolut Suport. Duket se edhe qetësia e natës gjatë gjithë së cilës zgjati udhëtimi ynë deri në të gdhirë të 11 korrikut jo vetëm që më shtyu në mendime, por ma bëri të pamundur gjumin. E para gjë që më rrokën sytë ndërsa nata ja linte vendin ditës, ishin mallet e larta dhe zhveshura, që ma përforconin edhe më shumë atë ndjesinë e një toke të zhuritur nga luftërat, jo thjesht të një shkretëtire natyrale. Kurse ndërsa avioni filloi t’i afrohej aeroportit, Kabuli i madh e kaotik, më solli në mendjet shprehjet “është bërë si Kandahar”. E pyeta veten në heshtje: “A do t’ja dalësh kësaj beteje?”

Pritja në Kabul

Ora shënonte 8.30 minuta. Edhe pse ishim pjesë e një misioni ushtarak, kjo nuk na bënte aspak të ndryshëm nga të tjerët në kontrollin e pasaportave, vizës e kështu me radhë. Atje jashtë në sallat e pritjes na prisnin kolegët që do të na shoqëronin në bazën e misionit. Të thjeshtë, pa emocione të tepruara si ato që përjetuam në Rinas, ata na përshëndetën dhe na uruan: “Mision të mbarë dhe suksese”. Përgjatë rrugës për në bazë përpiquesha të kapja çdo detaj, pasi tashmë misioni kishte filluar me të gjitha detyrimet e tij. Nuk bëhej më fjalë për një udhëtim të zakonshëm përmes kulturash, vendesh, njohja me Kabulin ishte pjesë e detyrës sime si ushtarake. Baza drejt së cilës po udhëtonim ishte baza ku ishin vendosur trupat e FA, të cilat kishin mbërritur aty gati një muaj përpara nesh. Kështu që ky takim mes kolegësh ishte jo vetëm pjesë e punës, por edhe një kënaqësi e veçantë shpirtërore. I takuam të gjithë një për një dhe natyrshëm pyetjet e para lidheshin me vijueshmërinë e misionit.



Përgjigjet e tyre pozitive na entuziazmuan dhe na shërbyen si frymëzim se mbarëvajtja e tij deri në përfundim do të ishte e sigurtë. Për trupat ushtarake mbajtja e moralit lartë në kohë lufte apo edhe gjatë përgatitjes për luftim është një art më vete. Dhe u ndieva tepër krenare për kolegët e mi, që ishin përshatur aq mirë me situatën. Të mbushur plot kurajo dhe besim ata ishin modeli më i mirë për ne në vazhdimësinë e detyrave të ngarkuara.

Marrja e detyrës

Mbërritja në bazë shënoi dhe marrjen e detyrës. Një pjesë e grupit e kishte pikërisht aty detyrën, kështu që menjëherë pa humbur kohë nisën procedurën e marrjes së saj në dorëzim. Për mua dhe dy kolegët e tjerë udhëtimi do të vazhdonte edhe pak, pasi ne ishim pjesë e Komandës së Resolutë Suport (HQ RS). Duket se do t’i riktheheshim edhe një herë fluturimit, po këtë radhë me një prej helikopterët ushtarakë të komandës. Edhe pse kam jo pak vite karrierë si ushtarake, gati 30 së bashku me vitet e shkollimit, ky ishte fluturimi im i parë me një mjet të tillë. Një përvojë e veçantë padyshim. Në teminalin e helikopterëve, në zbritje na prisnin kolegët, që do të bënin dorëzimin e detyrës, që shënonte njëkohësisht dhe përfundimin e misionit të tyre 6 mujor. Edhe pse ishim në një mjedis tërësisht ushtarak, ajo që të emocionon dhe të ngroh zemrën është pritja e kolegëve dhe eprorëve. Një pritje miqësore, një pritje që të zhvesh nga çdo ndjenjë ankthi e pasigurie, një pritje ku fjala e parë është: Mision të mbarë, me krahë të lehta dhe shumë urime dhe suksese. Shoqërimi me makina vazhdoi deri te godina ku do të akomodoheshim. M’u kujtuan vitet e shkollimit. Kursi i shoqeve të mia ushtarake me të cilat ndaja përditshmërinë time si studente. Kështu m’u duk vetja kur hyra në godinën e femrave ushtarake. Dhoma ime shënonte nr 202. E meqë tashmë isha në Kabul, mendova se ndoshta kushtet e banimit do të ishin përshatur me gjendjen në vend. Por kjo ishte një



Foto ilustruese

Resolute Support Mission			
Troop Contributing Nations			
	Albania		Germany
	Armenia		Greece
	Australia		Hungary
	Austria		Iceland
	Azerbaijan		Ireland
	Belgium		Italy
	Bosnia Herzegovina		Latvia
	Bulgaria		Lithuania
	Croatia		Luxembourg
	Czech Republic		Mongolia
	Denmark		Montenegro
	Estonia		Netherlands
	Finland		New Zealand
	Georgia		Norway
			Poland
			Portugal
			Romania
			Slovakia
			Slovenia
			Spain
			Sweden
			the former Yugoslav Republic of Macedonia
			Turkey
			Ukraine
			United Kingdom
			United States
			Total

tjetër surprizë. Çdo gjë ishte në vendin e vet. Në godinën e femrave ushtarake, gjeta përfaqësuese nga të gjitha shtetet e NATO-s dhe ambienti brenda godinës ka një klimë të shkelqyer, pasi nuk mungon afriteti, mirësjellja, bisedat e ndryshme që të njohin më nga afër me koleget, pasi ndajmë të njëjtat shqetësime e gëzime në lidhje me familjen, fëmijët, punën, duke diskutuar dhe treguar secila për shtetin e saj, për kulturën e historinë e vendit nga vjen. Drejtoria CAG (Command Action Group) HQ RS, vendosi që darkën e mirëseardhjes në mission ta bënin në Ambasada Amerikane në Kabul. Pas gati 24 orë nga fillimi i këtij udhëtimi, lodhja sigurisht po bënte të vetën, por gjumi nuk më zinte. Pata dëshirën të dëgjoja zërin e familjarëve të mi, t'i njoftoja se gjithçka kishte shkuar mirë, se baza ushtarake, nuk ishte aspak një vend i frikshëm, ku veç dashurisë së tyre, asgjë tjetër nuk mungonte. Vetëm në përfundim të kësaj bisede mbylla sytë, duke menduar të nësërmen.

Dita e parë e punës në Komandën

e Resolutë Suport

12 korrik 2015 do të ngelet në kalendarin e ditëve të mia si ushtarake dita e parë e punës sime në mision në Kabul, Afghanistan. Në orën 7 e 30 u paraqitëm në muncë si grup ushtarakësh shqiptarë të gjithë së bashku ne që do fillonim misionin dhe ata që do ta përmbyllnin misionin. Mencia është vendi ku padyshim humbet “nacionaliteti” më së pari. Ajo ishte e mbushur pothuajse plot, ku shumica ishin ushtarakë, po nuk mungonin edhe civilët. Hapësirat e saja ishin të mëdha mjaftueshëm dhe pastërtia binte menjeherë në sy. Të ngrënit në muncë nuk përbënte risi për asnjë nga ne që vinin prej jetës ushtarake, por ndodhja në një vend tjetër me një traditë kulinare krejt të ndryshme nga e vendit tonë, ku zotëron kulinaria mesdhetare, mund të ngrejë pyetjen se si ishte ushqimi? Në fakt ashtu si pothuajse gjithçka që ishte më tepër se nacionale, pra kishte një ngjyrim internacional, edhe ushqimi ishte i gjithëllojshëm dhe mundësia e zgjedhjes ishte e jashtëzakonshme. E

njëta gjë vlen edhe për llojet e ndryshme të frutave apo pijeve joalkolike. Përfundimi i mëngjesit shënonte dhe startimin e aktivitetit ditor në zyrë. Rrugën e bëra së bashku me kolegun që do ta dorëzonte detyrën. Takimi i parë i mëngjesit ishte parashikuar në orën 8.45 minuta. Një takim ku morrën pjesë të gjithë pjesëtarët e stafit të drejtorisë në të cilën isha caktuar të jepja kontributet e mia si ushtarake pranë kësaj komande. Në këtë takim u bë edhe prezantimi im për vazhdimin e misionit për 6-mujorin në vazhdim. Këtu nisën procedurat HOTO, dorëzimi dhe marrja e detyrës. Detyra ime më emocionoi shumë, së pari si grua e më pas si një ushtarake. Pozicioni i Strategic Advise in CAG, HQ RS, ka si targetgrup të veçantë punën me femrat në Ushtrinë Afgane dhe në Policinë Afgane. Për këdo që e njeh fatin që i ka shoqëruar vajzat dhe gratë afgane, gjatë kontrollit të vendit nga talibanët, kjo padyshim është një sfidë e vërtetë. Është një detyrë jo e lehtë, por e arritshme. Në një ditë pune në Komandën e Resolute Suport, veprim-

taritë ia lënë vendin njëra tjetërs. Sapo përfundon një takim, të duhet të nisësh një vidieotelekoferencë, një tjetër formë e re pune, ku zotërimi i teknologjisë dhe anglishtes janë pjesë e detyrueshme. Në zyrën e re jemi 5 kolegë, ku secili nga ne ka detyrën e tij dhe punën e tij në përbërje të CAG. Por edhe pse kjo që sapo thashë të krijon idenë e një pune individuale, në fakt puna në grup është baza e suksesit dhe motoja e komandës. Mirësjellja shoqëron çdo anëtarë të stafit, ata që kanë më tepër përvojë dhe më shumë kohë qëndrimi në komandë, janë të gatshëm të të ndihmojnë me çdo gjë. Të qënurit për herë të parë në një mision të kësaj natyre, jo vetëm nuk e shohin si një minus apo padije, por përkundrazi të inkurajojnë për guximin e marrë dhe të ofrojnë mbështetje për çdo gjë, paqartësi apo pyetje. Komanda e Misionit Resolute Suport me ambientet e saj të përngjason me një qytezë të vogël ushtarake. Ngado ku të lëvizësh, në mbledhje, takim, muncë, kryqëzohesh me ushtarakë që nxitojnë të përmbushin detyrat e tyre. Kjo më bënë që të ndiej nostalgji për mjediset e garnizonit “Skënderbej”. Gjatë këtyre lëvizjeve shumë prej portreteve që të parakalojnë janë akoma të panjohur për ty, por të gjithë kanë një karakteristikë të përbashkët. Buzëqeshja e ëmbël e tyre të shoqëron, së bashku me shprehjet tipike të mirësjelljes, padallim gjinie burra apo gra. Askush nuk kalon pa të përshëndetur me një : hi, hello, good to see you, etj etje. Përshendetja të bën të ndihesh më rehat, më mirë, më e familjarizuar me punën, ambientin dhe misionin.

Misioni nuk ka orar zyrtar

Përpara se të nisesha në mision detyra ime ishte pranë Shtabit të Përgjithshëm. Megjithëse ushtarakët nuk kanë orare, puna në zyrë kalonte përmes një orari zyrtar që niste në orën 8.00 të mëngjesit dhe mbyllej në orën 16.30. Por ajo që mësova në mision që në ditën e parë, është se ky orar zyrtar, “nuk ekzistonte” këtu. Në komandën e misionit, puna niste gjithashtu në orën 8.00 të mëngjesit, kurse mbyllja e zyrës mund të ndodhte edhe në orën 22.00 të mbrëmjes. Edhe e shtuna së bashku me të dielën, nuk konsiderohet një ditë pushimi, për nga punët e kryera ato janë njëlloj të rëndësishme e të ngarkuara si ditët e tjera të javës Po çfarë e bën kaq të ngarkuar ditën në mision. Ajo është e mbushur me trajnime sidomos kur je në fillimet e tua të para, takime, mbledhje etj. Ato që janë me një disiplinë të fortë janë oraret e pushimeve, ai i drekës në orën 12 e 30, apo ai i darkës 7 e 30. Ky i fundit të bën të kuptosh se dita ka fluturuar. Kthimi në zyrë është i padiskutueshëm, pasi vijnë e-mail-et e darkës që na njohin me gjithë aktivitetin e ditës së komandave dhe në RS, por edhe më detyrat , mbledhjet, takimet për ditën që vjen dhe për ditët

në vijim. Ky ritëm është i përditshëm. E nëse mendoni se të qënurit femër ushtarake në mision mund të përbëjë ndonjë dallim apo privilegj, këto janë koncepte të papranueshme. Të drejtat gjinore janë të barabarta, ashtu si edhe detyrat. Madje disa detyra mund të duken të habitshme, por ato janë pjesë e forcimit të ndjenjës së një komuniteti të përbashkët në mision. Çdo të dielë, i gjithë stafi zyrës, e më gjerë merr pjesë në pastrimin e saj. Dhe po me të njëjtën ndjenjë solidariteti, duke u ndjerë të gjithë ushtarakë të NATO-së, që punojmë për një qëllim të madh nuk mund të lë pa përmendur këtu, rreshtimin e të gjithë personelit të Komandës së Misionit Resolute Suport çdo të premteje në orën 11.30, në ceremoninë përkujtimore të të rënëve në luftë. Sepse kjo luftë ka pasur dëshmorët e saj, të cilët janë shembull frymëzimi e heroizmi. Në lajmet që japin Tv e ndryshme lajmet e Kabulit jo gjithmonë janë optimiste, por në takimet e shpeshta me kolonel Dilaver Hoxha nuk mungojnë kurrë udhëzimet në lidhje me misionin, madje ato më tepër se takime zyrtare, marrin edhe formën e një kafeje pune, duke i mëshuar idesë se qetësia në mision është baza e mbarëvajtjes, së bashku me korrektesën në orar, në raport me eprorët, dhe kyçi i një shëndeti dhe veprimtarie të sukseshme është shmangia e stresit.

Ushtarakja, nëna dhe gruaja në mision

Mbrëmjeve të qeta kur përmbyll ditën e punës në komandën e RS, kur shkoj në dhomë, unë jam përsëri nënë dhe bashkëshorte. Takimi me familjen në Skype, bënë pjesë sa te privimet, aq edhe te kënaqësitë e paçmuara. Si do që të ketë qenë dita, lodhja ikën kur flet me fëmijët. Por në përballimin e kësaj detyre kaq të rëndësishme, ndihem me fat sepse krah meje nuk kam vetëm një familje të fortë e të shëndetshme. Krah meje në këtë sfidë, që udhëheq me shembullin e saj dhe luan një rol të rëndësishm në promovimin e grave ushtarake, ndodhet ministri i Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli. Të drejtat e grave dhe vajzave në FA, ajo nuk i ka parë e trajtuar si privilegje, por si shanse. Dhe prania im në këtë mision është një shans që gratë ushtarake shqiptare të lënë gjurmë, edhe në misione të tilla si ky në Afganistan. Fjala e saj e ngrohtë më ka dhënë besim këtu në Kabul e largët, ku do të doja shumë që një ditë vajzat dhe gratë, të ishin pjesë aktive forcave ushtarake afgane dhe policisë afgane, në pozicione karriere. Që ato të mos vinin më përmes historive tragjike të përdhunimit, vrasjeve e shfrytëzimit, por si një forcë e rëndësishme në shuarjen e konflikteve. Për këtë dua të theksoj edhe një herë se jam e lumtur e ndihem me fat, që përfaqësoj gratë e vajzat ushtarake e FA për këtë periudhë 6 mujore në komandën e RS, duke shpresuar se të tjera gra, vajza, mike të mia ushtarake do ta vazhdojnë këtë rrugë.



Histori treguar përmes posterave

MIMOZA GOLIKJA

Në faqen e internetit të NATO-s për herë të parë, janë publikuar postera që pasqyrojnë frymën e NATO-s në të kaluarën. Ky koleksion unik artwork përfshin postera të krijuara në NATO dhe sende të tjera të dhuruara NATO-s nga organizata të ndryshme dhe individë. Të mbledhura në seksionin e Historisë në website-n e NATO-s, pesë galeritë e reja janë titulluar “Paix et Liberté” (Paqja dhe liria), “Si punon NATO”, “Uniformat”, “Përvjetorët” dhe “Afganistani”.

Një numër posterash tregojnë gjithashtu shtrirjen gjeografike të NATO-s, të 15 vendeve anëtare, rreth viteve 1955.

Stili dhe ndikimi italian janë të dukshme në koleksionin e posterave që janë grupuar në serinë me titull “Paix et Liberté”, i prodhuar në vitin 1951 nga organizata “Joqeveritare paqe dhe liri” nga San Remo e Italisë.

Grupi i posterave të mbledhura nën titullin “Uniformat”, janë përdorur filimisht si një mjet për të mësuar forcat në shtetet aleate dhe se si ato të njohin njëri-tjetër nëpërmjet veshjeve ushtarake. Qendra e Edukimit Ushtarak në Mbretërinë e Bashkuar i kërkoi secilit shtet anëtar të NATO-s për të sjellë një poster që tregon uniformat dalluese dhe renditjen në vitet 1950. Kjo seri e posterave është prodhuar në fillim të viteve 1960.

Një tjetër koleksion, grupi i posterave që filloi si një mjet edukativ, është seria që mban titullin “Si punon NATO”. Ky koleksion i viteve 1950 dhe 1960 tregon se shpjegimet vizuale janë përdorur në një kohë kur organizata ishte më pak e njohur.

“Përvjetori”, është titulli tjetër i koleksionit të posterave që shënon ditëlindjet e NATO-s të 10, të 30 dhe të 40. Këto vepra arti janë pikërisht ato që përfshijnë vitet nga 1950 deri në 1980.

Koleksioni i fundit i posterave i titulluar “Afganistani” (2009), përfaqësohet më shumë nga seksioni i kronikave përmes fotografisë, që paraqesin aktivitetin e forcave ndërkombëtare dhe të forcave afgane gjatë misionit ISAF të udhëhequr nga NATO. Posterat janë projektuar nga Shërbimi Grafik i NATO-s. Posterat më të fundit janë të shumta, ato janë një numër i madh posterash të grumbulluara dhe të mirëpritura që tregojnë për “Planin Marshall”, të krijuara në vitet 1950.

Historia që vjen përmes posterave tregon për atë që shpesh është thënë se Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut u themelua në përgjigje të kërcënimit nga Bashkimi Sovjetik. Kjo është vetëm pjesërisht e vërtetë. Në fakt, krijimi i Aleancës ishte pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për t'i shërbyer tre qëllimeve; pengimin e ekspansionizmit sovjetik, ndalimin e ringjalljen e militarizmit nacionalist në Evropë dhe inkurajimin e integritetit politik evropian, përmes një pranie të fortë të Amerikës së Veriut në kontinent.

Pasojat e Luftës së Dytë Botërore ishin të dukshme në shumë vende të Evropës tashmë të shkatërruar në një mënyrë që kishte qënë e vështirë të



parashikohej. Rreth 36.500.000 evropianë kishin vdekur në këtë konflikt të paparë, prej të cilëve 19 milionë civilë. Kampet e refugjatëve dhe racionimi dominonin jetën e përditshme. Në disa zona, normat e vdekshmërisë foshnjore ishin një në katër. Miliona jetimë endeshin në ish metropolet

e djegura nga predhat. Në qytetin gjerman të Hamburgut, gjysmë milioni njerëz ishin të pastrehë.

Që nga themelimi i saj në vitin 1949, fleksibiliteti transatlantik i aleancës, shënuar në themel të Traktatit të saj origjinal, e ka lejuar atë që t'iu përshtatet kërkesave të ndryshme të kohës të ndryshme. Në vitet 1950, Aleanca ishte një organizatë krejtësisht mbrojtëse e në vitin 1960, NATO u bë një instrument politik. Në vitet 1990, Aleanca ka qënë një mjet për stabilizimin e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore nëpërmjet inkorporimit të partnerëve të rinj dhe aleatëve. Tani NATO ka një mision të ri, të shtrijë paqen me anë të projektimit strategjik të sigurisë. Ky është misioni i nevojshëm të cilin kanë qënë vetë ngjarjet ato që ia kanë diktuar aleancës këtë mision.

Koleksioni i Posterave

Koleksioni i NATO-s apo i posterave të lidhura me NATO-n, në posedim të organizatës edhe pse është ende i paplotë, krahasuar me historinë dhe aktivitetin e madh të aleancës, NATO nga ana tjetër posedon një numër të madh të tyre që tregojnë për historikun e saj që nga krijimi. Në eëbsite-n e saj NATO ka publikuar se disa nga posterat nuk janë prodhuar nga vetë Aleanca, prandaj “ju lutemi informoni për materialin dhe për të drejtën e autorit në rast se është përdorur pa të

drejtë ose kataloguar në infoproducts@hq.nato.int ~ ~ pobj”. NATO gjithashtu ka publikuar edhe se, mirëpret çdo donacion posterash, të NATO-s ose të lidhura me NATO-n, “që dëshirohet të dhurohet për të ndërtuar koleksionin e NATO-s”. Për këtë qëllim, NATO vë në dijeni se është e njëjta adresë e-maili e vënë në përdorim. NATO gjithashtu njofton se “të gjitha posterat mund të riprodhohen për qëllime arsimore dhe jo-komerciale”. Më poshtë po sjellim detaje të koleksionit të madh të posterave sipas serive.

Plani Marshall ose Programi i Rimëkëmbjes Evropiane: Ky koleksion posterash i është dhuruar NATO-s nga Plani Marshall. Koleksioni është pjesë e një konkursi posterash, i nisur nga Programi i Rimëkëmbjes Evropiane në vitin 1950. NATO posedon 17 nga 25 postera fituese që janë paraqitur nga artistët nga e gjithë Evropa në temën e bashkëpunimit dhe rimëkëmbjes ekonomike. NATO i paraqiti ato në turneun e saj me autobus në Evropë në vitet 1950.

Paix et Liberté (Paqja dhe liria): Këto postera janë postera të cilat janë prodhuar nga organizata joqeveritare “Paix et liberté” (Paqja dhe liria), dega Evropiane me qendër në San Remo të Italisë, e kryesuar nga Jean-Paul David, deputet francez. Ky koleksion posterash i është dhuruar me mirësi NATO-s në vitin 2012 nga Charles N. Spofford, djali i parë i Përfaqësuesit të Shteteve të Bashkuara në NATO (1950-1952), Ambasadori Charles

M. Spofford.

Si punon NATO: Këto postera janë krijuar për arsye edukative dhe shumë prej tyre u riprodhuan në botimet e NATO-s. Origjina e tyre e saktë nuk është se mund të gjendet gjithmonë. Në disa raste, seri të tyre janë krijuar nga Shoqata Kombëtare e Traktatit të Atlantikut, siç ishin shumë prej posterave të krijuara në ditët e para të Aleancës.

Posterat e përvjetorit: Këto postera janë krijuar për të shënuar përvjetorët e Aleancës, duke sjellë caste dhe momente historike dhe emocionale.

Posterat e NATO-s në Afganistan: Koleksioni i këtyre posterave përkohë me 60-vjetorin e samitit të NATO-s, të organizuar bashkërisht nga Franca dhe Gjermania në Strasburg dhe Kehl. NATO

zhvilloi një fushatë të të ekspozimit në ekran në sistemin e metrosë, në Uashington, DC, nga 23 marsi deri më 19 prill 2009. Dizajni i këtyre posterave është bërë nga Shërbimi Grafik i NATO-s.

Uniformat dhe emblemat: Këto postera janë prodhuar nga Ministria e Mbrojtjes e Mbretërisë së Bashkuar (Departamenti i Ushtrisë) dhe të shtypura nga Ltd. Macmillan Derby. Qendra e Edukimit Ushtarak UK donte të njihte nga afër Forcat e çdo vendi anëtar të NATO-s me uniformat dhe shënjat.

Postera arsimore: Ky koleksion posterash është koleksion posterash të cilat janë zhvilluar si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për të prodhuar materiale mësimore për përdorim në klasë. Ato në mënyrë specifike kanë për qëllim të rrisin ndërgjegjësimin mbi NATO-n dhe aktivitetet e saj në vendet anëtare.

Postera të Ngjarjeve: Një përzgjedhje e posterave që mbulojnë ngjarje të tilla që kanë lënë gjurmë në historinë e NATO-s ose nisma të reja me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore.

Posterat e sigurisë: Siguria e brendshme ka qënë gjithmonë një prioritet i NATO-s. Gjatë viteve, posterat, kartat, fletpalosjet dhe kalendaret kanë stolisur muret dhe tavolina brenda Shtabit, duke i kujtuar punonjësve të NATO-s për rëndësinë e gjykitit. Këto objekte kulturore janë jo vetëm dhuratë por referencë dhe dëshmi për situatat e kohës sonë.



Deklaratë e zëdhënësit të NATO-s mbi situatën në Ukrainën lindore

Në fokus, zgjidhja me mjete diplomatike

Më 19 gusht 2015, aleatët e NATO-s diskutuan situatën në Ukrainën lindore. Aleatët shprehën shqetësimin e tyre serioz në lidhje me përshkallëzimin e dhunës së mprehtë.

Në diskutime, aleatët theksuan nevojën e të gjitha palëve për të përshkallëzuar tensionet dhe për të ushtruar vetëpërmbytje.

Ata nënvizuan se fokusi duhet të jetë në ndjekjen e një zgjidhjeje me mjete diplomatike. Zbatimi i plotë i marrëveshjeve në Minsk është rruga drejt paqes.

Rusia ka një përgjegjësi të veçantë për të gjetur një zgjidhje politike. Çdo përpjekje nga ana e separatistëve, të

mbështetur nga Rusia, për të marrë përsipër më shumë territore të Ukrainës, do të ishte e papranueshme për komunitetin ndërkombëtar.

Monitoruesit e OSBE-së duhet të jenë në gjendje të bëjnë punën e tyre në mënyrë të sigurtë dhe pa kufizime.

NATO qëndron e vendosur në mbështetjen e saj për sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës.

Aleatët ripohuan se një Ukrainë e pavarur, sovranë dhe e qëndrueshme, e angazhuar në mënyrë të vendosur për demokracinë dhe sundimin e ligjit, është kyçi për sigurinë në zonën Euro-Atlantike.

NATO do të vazhdojë të ndjekë me shumë kujdes situatën.



Spanja përgatitet për stërvitjen më moderne të NATO-s

Starton "Exercise Trident Juncture 2015"

Ushtrimet do të përfshijnë rreth 36.000 personel prej më shumë se 30 vende aleate dhe vende partnere, nën drejtimin e 650 komanduesve

Panorama në Zaragoza të Spanjës të prezanton me ushtarët që punojnë 14 orë ditë, nën efektin e kushteve atmosferike, të erës të fortë, të rezeve të diellit e të temperaturave të larta. Por kjo është vetëm një pjesë e asaj që po ndodh tani në Zaragoza, e cila parashikohet të jetë qendër e një stërvitje të përbashkët. Shtabi i task forcës të drejtuar nga personel i JFC Brunssum, do të vendoset në "një qytet tendë". Puna është në rritje, me qëllim për të sistemuar dhe bërë gati gjithçka që duhet për stërvitjen.

Stërvitja më ambicioze në historinë moderne të NATO-s, po aq ambicioze janë dhe kërkesat dhe përkrahja logjistike që duhet. Grupi i Mbështetje së Stërvitjes kishte për detyrë të ngrinte një "qytet tendë" në kohën e duhur për stërvitjen e cila është planifikuar të nisë në javën e fundit të shtatorit. Për të përmbyshur afatin, 392 kontejnerë me të gjitha pajisjet e nevojshme mbërriti në bazë në fund të korrikut dhe rreth 120 ushtarë nga Austria, Gjermania dhe SHBA janë duke u marrë me vendosjen e pjesëve të këtij pazëlli gjigand së bashku.

Toger Filipi Morrison, komandant i Grupit Mbështetës, përshkruan procesin: "Planet për pozicionimin e saktë të çdo tende të vetme, kontejnerëve dhe të gjitha letërsirave në kamp janë hartuar një vit më parë dhe u miratuan në dhjetor 2014. Çfarë



ishte e lehtë në letër, rezultoi të ishte një sfidë e vërtetë këtij, veçanërisht pasi temperaturat janë shpesh mbi 32 gradë Celsius, erërat e forta që

kthejnë çdo pjesë e çadrës në një jaht-lundrimi, dhe orët e gjata të punës kombinohen për të paraqitur sfidën e vërtetë".

Kur u pyet në lidhje me pengesën më të madhe, Toger Morrison përgjigjet: "Ne jemi duke u ndeshur me sfida të cilat nuk i parashikonim, por mësimet që nxjerrim do të jenë të vlefshme për NATO-n në të ardhmen".

Disa vende të tjera në Spanjë, sikurse dhe Italia dhe Portugalia, janë gjithashtu duke u përgatitur për "Trident Juncture 2015", por Zaragoza është unike. Pesëmbëdhjetë kilometra në veri-lindje të bazës ajrore ka ndërtime të shumta rrugore dhe punime të ndryshme për ndërtim që zhvillohen në zonën e trajnimit në San Gregorio.

Komanda e Forcës së Përbashkët

Brunssum do të dërgojë mbi 650 anëtarë të stafit të saj për të komanduar, kontrolluar dhe koordinuar veprimet e 36.000 trupave të ardhur nga më shumë se 30 kombe.

Ushtrimi "Trident Juncture 2015" përfshin rreth 36.000 personel prej më shumë se 30 vendeve aleate partnere. Ajo do të zhvillohet në të gjithë Italinë, Portugalinë, Spanjën, Oqeanin Atlantik, Detin Mesdhe, Kanadanë, Norvegjinë, Gjermaninë, Belgjikën dhe Holandën. Trident Juncture 2015 do të demonstrojë nivelin e rriur të ambicies të NATO-s,

në konfliktin e përbashkët modern dhe do të tregojë një aleancë të gatëshme dhe të denjë e pajisur me aftësinë dhe kapacitetin për të përmbyshur sfidat e tanishme dhe të ardhshme të sigurisë. Më shumë se 12 organizata të mëdha ndërkombëtare, agjenci të ndihmave dhe organizata joqeveritare, si dhe Bashkimi Afrikan dhe Bashkimi Evropian, do të marrin pjesë në stërvitje, duke demonstruar përkushtimin dhe kontributin e NATO-s për një qasje gjithëpërfshirëse për menaxhimin e krizës.

Mimoza Golikja



NEDIM GJONI

Veterani i Luftës dhe një nga themeluesit e Artilerisë Kundërajrore

ALBERT Z. ZHOLI
LELO LELI (N/ KOLONEL (R))

Kuadrot e vjetër të ushtrisë, ata që i kanë dhënë armatës së mbrojtjes së atdheut mendjen, dijet dhe jetën e tyre mes sakrificave të mëdha mbeten gjithmonë thesare për brezat. Vitet ikin dhe ata me heshtjen e tyre, mbartin brenda vetes dhe subkoshiençës, ngjarje, data, eksperiencë që patjetër duhet tu mirret. Një ndër ta është dhe oficeri veteran, Nedim Gjoni. Veteran dhe një nga kuadrot me vlera të Artilerisë Kundërajrore, që ka kontribuar shumë për rritjen dhe forcimin e saj. Tashmë është 88 vjeç, por kurrë nuk e tregon moshën.. Ecën lehtë, me një shkop, si “shokun më të mirë”. Me ato hallet e moshës, por mendjen e ka të freskët. Ke dëshirë ta dëgjosh. Me kompetencë e vërtetësi të flet për problemet e kohës së parë (sicc thotë ai për monizmin) dhe ato të kohës. Burrë i mençur. Me një mal kujtimesh, vlera e virtyte. Njihet se çdo njeri në kurbën e jetës krijon një histori. Të shkruar, ose jo. Veterani Nedim Gjoni ka një histori me shumë arritje e vlera. Histori lufte me armë e trimëri. Histori pune e drejtimi me shumë mund e sakrifica.

Jetëshkrimi

Jeta e tij ka dhimbje, por dhe frymëzim e krenari. Lindi, në Janar 1927, në Kallarat të Labërisë. Në një familje të thjeshtë, me ndjenja të thella atdhetare. Gjyshi dhe babai i tij kanë luftuar me armë kundër andartëve grek dhe më 1920 kundër italianëve, që siç njihet- në Luftën e Vlorës. Nedimi ishte më i vogëli, në mes tre vëllezërve. Fati e pruri që t’ju vdesin të dy prindërit. Të tre jetimet ngelën me gjyshen e tyre të moshuar. Jeta ecte me plot vuajtje e varfëri! Nedimi fëmijë shkon në Kuç, tek daja i tij. Burri i urtë, MuhoJonuzi e riti bashkë me djemtë e tija. Atje mbaroi shkollën filllore. Në Kuç, mes atyre burrave e grave fisnike u pajis me cilësitë më të mira. Siç tregojnë bashkëmohatar të tij, ai kishte dhuntinë që të thithte mendimet më të vlefshme për jetën. Ashtu, siç përqafoi shpejt idetë e lëvizjes nacional-çlirimtare për ngritjen me armë kundër pushtuesve. Siç njihet nga historia, Kuçi u lidh, që në fillim me luftën Nacional-Çlirimtare. Burrat e mençur me MemoMeton e të tjerë ditën të sqaronin njerëzit dhe ti hedhin në luftën e drejt për shpëtimin e atdheut që rënkonte nënë pushtimin nazi-fashistë. Si shumë të tjerë, Nedim Gjoni i ri, 15 vjeç merë armën dhe rreshtohet në formacionet partizane:- në çetën Sulo Lala, në batalionin IsmailHakui, e më pas në Br14-S.

Aksioni i parë dhe lufta

Aksioni parë ka qenë më 10 Nëntor 1942, për asgjësimin e postëkomandës fashiste në Kuç, më pas të administratës fashiste në Gusmar, si dhe në luftimet në rrethinat e Sarandës e të Gjirokastrës. Në këto luftime u burrërua, fitoi cilësi e aftësi. Në të gjitha aksionet luftarake luftoi me trimëri e vetëmohim. Nedimi partizan luftonte për një ideal të lartë: Çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit nazi-fashistë. Ashtu luftonin dhe dy vëllezërit Xhemali, efektiv i Br6-S. dhe Tarja në Br I-S. Në çdo luftim, në ballë, me trimëri e sakrifica. Tarja, mitraljeri



trim bie heroikisht në përleshje me forcat gjermane, në Berat. Vëllezërit Gjoni nuk kursyen asgjë për vendin. E kuqën tokën, që Shqipëria të ishte e lirë. Bijtë e bijat më të mirë të kësaj toke i dolën zot Shqipërisë të robëruar e të prapambetur. Ata nuk e lanë Shqipërinë e shtrenjtë, që ujqër e çakej ta bënin copa- copa. Të përsëritej historia. Lufta nacional-çlirimtare është faqja më e lavdishme në historinë e Shqipërisë. Ajo periudhë është plot histori trimërie, mençurie, atdhedashurie e sakrificash të panumërta. Lufta e drejtë e radhiti Shqipërinë në anën e fitimtarëve, të koalicionit Anglo- Amerikan- Rus. Janë disa pasardhës të atyre që ikën me pushtuesit dhe erdhën si diversant, duke lënë kockat në burgjet e malet shqiptare, e të tjerë që hedhin baltë mbi luftën çlirimtare. Jo, kurrë nuk duhet mohuar gjaku i derdhur lum i mijëra djemve e vajzave partizane për Nënë e madhe Shqipëri . Ata luftuan dhe dhanë jetën për Shqipëri e për flamur! Historianët, burrat e mençur do ta shkruajnë historinë me vërtetësi. Ai brez ishte dhe ngeli brezi i ART.

Mbas çlirimit të Shqipërisë, artiljer kundërajror

Mbas çlirimit të Shqipërisë, Nedim Gjoni, e qindra të tjerë të moshës të tij dërgohet në shkollën ushtarake “Skënderbej”. Ajo, siç dihet, u hap në Mars 1945 në Tiranë. Nxënësit e parë ishin partizanët më të rinj, që ktheheshin nga lufta me armë. Duke qenë në mes më të mirëve, dërgohet për studime në Jugosllavi e më pas, 1949-1952 në ish BS. për Artilerinë Kundërajrore. I kalituri në zjarrin e luftës, i pajisur me dije të qëndrueshme ushtarake, e sidomos njohës i armës të artilerisë kundërajrore, kthehet në Shqipëri i mbushur me dije. Bashkë dhe me oficerët, si Maqo Zoto, BejdoIsufi, KiçoJanko, NaunGjinikasi, Qazim Shtylla, CaneRama e të tjerë kontribuan shumë për rritjen dhe fuqizimin e asaj arme, aqë të domosdoshëme për mbulimin e hapësirës ajrore të

Shqipërisë tonë të shtrenjtë. Artileria Kundërajrore u rrit në cilësi me mitraloza: 12.7,m/m, 14.5 dy e katër gryksh dhe me topa – 37e 57m/m, një e dy gryka, topa 100 m/m. me drejtim elektrik, mjete radioteknike e Raketat. Ashtu siç u rrit shumë dhe në sasi, duke u hapur në gjithë vendin, me kuadro e specialist të zot. Ka mbaruar Akademinë Ushtarake. Ka marrë pjesë në forma të shumta të përgatitjes. Me vlerësime. Shumë dekorata e urdhra, që i ndrisin gjoksin. Nedim Gjoni kaloi në gjithë detyrat, nga bateria në grup, operativ, shef-shtabi e komandant regjimenti kundërajror. Për 6-7 vjet ka kryer detyrën e komandantit të MKA. në Korpusin e Burrelit. Andej erdhi përsëri në repartet e artilerisë kundërajrore, në Tiranë, deri sa doli në pension. Në detyrat që ka kryer ka treguar mençuri, iniciativë e përkushtim. Rezultatet, si në stërvitje, gatishmëri, rregull e disiplinë kanë qenë matësi i punës të mirë të tij. Shokët që e akne njohur Nedim Gjonin flasin për fjalët më të mira. Kam

folur dhe kam ruajtur për atë respekt të veçantë. Po ashtu mirë e shumë mirë kanë folur dhe të tjerë. Disa kanë shkruar, siç janë ÇerçisLeli, XhaferPeçi e DalanMemushi, Et`hemMerko e Nasip Ibrahim. Në mes të kundërajrorëve, Nedimi njihet si oficeri, që ka folur kurdoherë hapët, troç, pa frikë. Larg skemave e zbukurimeve. Kurajoz. U pëlqenin ose jo drejtuesve të tij. Dëgjohej me vëmendje kur fliste, e ngrite probleme. Rreth Nedimit rinin një numër i madh oficerësh për mendimet e shakatë, me atë humorin e hollë. Është dhuntia, shtysë e brendshme, që shpesh të flas me figura letrare, me atë intuitën e hollë, siç e ka traditë vendi i lindjes. Humor me kripë. Tepër gazmor. I pa pajtuar me të metat e llafollogët. I mbronte dhe i donte njerëzit e punës. Duke qenë njeri i ndershëm, i drejt,i shoqëruar me oficerët e ushtarët ka gëzuar gjithnjë respektin dhe mbështetjen e tyre në plotësimin e punëve dhe detyrave të gatishmërisë, që atëherë kërkohet të

ishte në shkallën më të lartë. Nga metoda e punës, virtytet e cilësitë e tij kanë mësuar dhe shumë të tjerë. Nedim Gjoni ka qenë një oficer model, me shumë vlera.

Në pension

Nedim Gjoni, dhe në pension ka punuar pa u shkëputur nga punët si veteran dhe kuadër ushtarak. Fjalët e mençura të tij janë dëgjuar në çdo rast. Si të tjerët, i prit me qetësi ndryshimet që u bënë, me ardhjen e Demokracisë, duke shpresuar në punët më të mira dhe gjendjen e shëndosh të Shqipërisë, për të cilën është derdhur gjaku si ujët e lumit. Njeriu, që ka kritikuar të metat që në rininë e tij nuk mund të pajtohet me ata që sot mohojnë çdo arritje, çdo gjë pozitive nga ai sistem që lamë pas. Kritika ka dhe për kryesinë e organizatës të veteranëve: Të luftojnë më shumë për mbrojtjen e luftës e gjakun që u derdh lum për Shqipërinë, si dhe të kujtohen për veteranët në periferi e të sëmure. Është bërë tashmë traditë, që oficerët kundërajror në pension mblidhen grupe-grupe për të pirë kafe e takuar me njëri-tjetrin. Takimin e fundit Kështu, edhe kohën e fundit pimë kafe me ishte plot energji, gazmor dhe fliste me pasion. E po, muhabeti nga secili shkon tek :-“Janë bërë punë të mira. Kemi vënë gjithçka për vendin. Erdhëm nga lufta. Nga Shqipëria e prapambetur, me mbi 90 o/o analfabet - në elektrifikimin, ngritjen e uzinave, fabrikave dhe kombinateve, shkollave me nivel të lart, spitaleve për të gjithë, hekurudhave, bonifikimeve e shumë të tjera. Por dhe dobësitë që na kanë shoqëruar i vlerësojmë, i kritikojmë. Ky burrë serioz burrin gjithë qenien,mendjen, zëmrën e shpirtin e tij ja ka kushtuar vendit, Shqipërisë të dashur. Ai i takon brezit më të lavdishëm, që luftuan me dy ushtri pushtuese, mësuan dhe punuan me ndërgjegjeje të lart për ta nxjerr Shqipërinë nga errësira e prapambetja. Ai ishte dhe mbetet një atdhetar e patriot i vërtet. Njeri i ndershëm, i drejt e modest. Për oficerin kundërajror, të përgatitur, të përkushtuar për punët e detyrat, që pa shkelur rregullat, dinte ti mbante afër oficerë e ushtarë dhe ti mobilizonte në punët e kohës. Oficerit që gjendesh gjithnjë në mes të njerëzve me shembullin dhe fjalën e ngrohët. Dhe tashti, në këtë moshë të thyer, del nga shtëpia i veshur pastër, me rroba të hekurosura, e takohet me kuadro kundërajror dhe të tjerë. Është lezeti i muhabetit, pasi kujtimet e tij për artilerinë kundërajrore nuk kanë të sosur. Ai mbetet një arkiv lëvizës me vete.



Përgatiti: Kapiten ERVIN HODO

Kush është Legjioni i Huaj Francez

Legjioni i Huaj është njësia e vetme e Ushtrisë Franceze e hapur për çdo kombësi. Të gjithë pjesëtarët e Legjionit të Huaj janë meshkuj, femrat nuk prano-hen. Shumica e legjionarëve vijnë nga Europa, por ka një përqindje në rritje të personelit që vjen nga Amerika Latine. Shumica e oficerëve të Legjionit të Huaj janë francezë, afërsisht 10% e tyre janë ish- legjionarë, të cilët janë rritur në gradë dhe detyrë. Në të kaluarën, legjionarët ishin të detyruar të rekrutoheshin nën një pseudonim (“declared identity”). Kjo dispozitë ekzistonte, në mënyrë që t’iu krijonte mundësi njerëzve që duan të fillojnë jetën nga e para si rekrutë. Legjioni i Huaj francez, beson se është më e drejtë që të gjithë rekrutët të përdorin indentitetin që deklarojnë. Shtetasit francezë, mund të rekrutohen nën një pseudonim, ose shtetësi të huaj. Që nga 20 Shtatori 2010, rekrutët e rinj, mund të regjistrohen me identitetin e tyre të vërtetë, ose nën një pseudonim. Rekrutët që regjistrohen me pseudonim, kanë mundësinë që pas një viti shërbimi, të përdorin identitetin e tyre të vërtetë. Pasi të kenë shërbyer në Legjion për tre vjet, legjionarët mund të aplikojnë për nënshtetësinë franceze. Ata duhet të shërbejnë me identitetin e tyre të vërtetë, nuk duhet të kenë më probleme me autoritetet si dhe duhet që të kenë shërbyer me nder dhe besnikëri. Për me tepër, një ushtar që plagoset gjatë një beteje për Francën, menjëherë mund të aplikojë për nënshtetësinë franceze, nën një dispozitë të njohur si “francez nga gjaku i derdhur.” (“Français par le sang versé”).

Ndërkohë që Legjioni i Huaj nuk pranon femra, duhet të përmendim se ka pasur zyrtarisht një femër, Briton Susan Travers, e cila u bashkua Forcave të Lira Franceze (Free French Forces) gjatë luftës së Dytë Botërore dhe u bë një anëtare e Legjionit të Huaj pas lufe, duke shërbyer në Vietnam gjatë luftës së Parë në Indokinë.

Sipas Neil Tweedie i The Daily Telegraph, nga 2008, shumë rekrutë kanë ardhur nga klasa e mesme, për shkak të rritjes së kushteve dhe profesionalizmit, në Legjionin e Huaj Francez. Legjioni, beson se trupa po bëhet pak e butë dhe dobët. Një legjionar Jug Afrikan, Tetari Buys Francois, thotë se Legjioni po merr rekrutë të rinj me diploma universitare, apo burra të divorcuar, të cilët duan t’i shpëtojnë pagesave për bashkëshortet dhe fëmijët e tyre, këta ata (më të vjetrit) i quajmë “Brezi i Play Station”, sepse janë shumë të butë, shumë qullashë.

Kushtet për tu bërë pjesë e Legjionit të Huaj Francez

- Mund të rekrutohesh vetëm në Francë (Sigurohen menjëherë ako-modim, ushqim, veshmbathje falas)
- Përzgjedhja, zhvillohet vetëm në zyrat franceze të rekrutimit.
- Përzgjedhja, zhvillohet në Aubagne, afër Marseille dhe përfshin:
 - Testim psikologjik
 - Testim mjekësor
 - Testim fizik
 - Nëse përzgjidheni si kandidaturre e mundshme, kontrata e parë është minimumi 5 vjet.
 - Kontratat e mëvonshme janë nga 6 muaj deri në 5 vjet.
- Për minorenët nën 18 vjec, kërkohet leja nga prindërit, kjo në një format që



është i disponueshëm në Xhandarmërinë Francëze, ose në Ambasadat jashtë Francës

- Cfarëdolloj statusi martesor të keni (beqar, i martuar, i divorcuar), ju do të rekrutoheni si beqar.
- Duhet të keni një dokument të vlefshëm identifikimi.
- Duhet të jeni fizikisht në formë të qëndrueshme, për të shërbyer në cdo kohë dhe në cdo vend.
- Stërvitja bazë
- Stërvitja bazë, zhvillohet në Regjimentin 4-rt të Huaj më një kohëzgjatje prej 15 javësh.
- Stërvitja fillestare, zgjat 4 javë dhe ka të bëjë me familjarizmin me jetën ushtarake dhe përfshin: ushtrime në terren; mësimi i traditave të Legjionit të Huaj, mësim i gjuhës frënge.
- Marshimi Képi Blanc, një marshim 100–120 km me të gjitha pajimet (Nga Perpignan dhe kthim në Bazën e Stërvitjes Bazë në Castelnau),
- Stërvitje taktike dhe praktike (duke alternuar me stërvitjen në kazermë dhe në terren) e cila zgjat 3 javë.
- Stërvitje malore,- një javë.
- Stërvitje taktike dhe praktike (duke alternuar me stërvitjen ne kazermë dhe në terren) për dy javë të tjera.
- Provime për marrjen e certifikatës elementare – një javë.
- Marshim për mbylljen e trajnimit bazë.- një javë.
- Shkolla për drejtimin e mjeteve të lehta dhe kamionëve të rëndë- një javë
- Kthim në Aubagne përpara emërimit në regjiment.- një javë.

Pagesa në Legjionin e Huaj Francez

Janë të shumtë njerëzit, të cilët pyesin në lidhje me rrogën mesatare të legjionarëve të Legjionit të Huaj Francez. Për t’iu përgjigjur kësa py-

etje, ne iu referuam prezantimit zyrtar që bëhet në websitin e rekrutimit, të Legjionit të Huaj Francez. Aty mund të shikoni shembujt në lidhje me rrogën, në varësi të gradës dhe vitetve të shërbimit, si dhe në bazë të njësisë në të cilën punojnë legjionarët. P.sh rroga e një legjionari në Regjimentin e parë është 1205 euro, në Regjimentin e parashutistëve është 1460 euro dhe një

strehimit, ushqimit dhe veshmbathjes, dhe kjo përfshin të gjithë legjionarët, gjatë vitit të tyre të parë në Legjionin e Huaj.

Çdo legjionar që ka mbi një vit kohë shërbimi, ka të drejtën e 45 ditëve leje vjetore. Rroga me e madhe në regjiment (pa përfshirë oficerët) përfaqësohet nga Kapterri, i cili ka mbi 21 vite shërbimi. Rrogat e tyre, variojnë nga 2078 euro

Gradë	Vite shërbimi	1 ° RE	2 ° REP *	3 ° REI **	13 ° Dble ***
Legjionar	10 muaj	€ 1205	€ 1460	€ 1433	€ 3567
PR II	3 vjet	€ 1226	€ 1480	€ 1452	€ 3626
N/tetar	7 vjet	€ 1303	€ 1607	€ 1600	€ 3939
N/Tetar i vietër	10 vjet	€ 1351	€ 1648	€ 1650	€ 3929
Tetar	10 vjet	€ 1779	€ 2095	€ 1945	€ 4186
Adjutant	17 vjet	€ 2007	€ 2140	€ 2180	€ 4748
Kapterr regjimenti	21 vjet	€ 2078	€ 2427	€ 2477	€ 4818

legjionar pjesëtar i Regjimentit të tretë e ka rrogën 1433 euro.

Bazuar në pozicionet e tyre zyrtare, rroga më të cilën fillojnë punë legjionarët është 1043 euro, përveç sigurimit të

në Regjimentin e parë, në Regjimentin e dytë parashutistët e të njëjtës gradë marrin 2427 euro, ndërkohë që në Regjimentin e tretë me të njëjtën gradë marrin një rrogë prej 2477 euro.

“I formuar në vitin 1831, në këtë korpus lejohet rekrutimi i pavarur i shtetasve të huaj, duke e bërë kështu njësinë e vetme të kësaj natyre në ushtrinë franceze”.

Rroga neto (pas heqjes së disa taksave si dhe pagesave për sigurimet shoqërore dhe sociale)

- * Bonus për parashutën
- Pagesat për misione ** (në territorin e Francës)
- Pagesat për misione*** (jashtë)

Rrogës i shtohen edhe kompesime të ndryshme.

Kodi i legjionar i nderit dikton sjelljen e këtyre njerëzve çdo ditë , në kohë lufte , si në kohë paqeje. Tradita e Legjionit të Huaj është çimentuar tashmë deri në detaje ku përfshihen: veshja, simbolet, emblemat e veçanta e deri te festimet këngët, muzika etj.

Imazhi që ata përcjellin në publikun e gjerë është unik dhe objekt frymëzimi në e realizimin e veprave të shumë artistëve si në: kinematografi, arte figurative, letërsi etj.

Pjesëmarrja e luftëtarëve nga vendi në Luftën e Vlorës 1920



Prof. Asoc. DR. BERNARD ZOTAJ



Kryengritjen e armatosur që nisi popullsia patriotike e krahinës së Vlorës kundër pushtuesit italianë, u shndërrua shpejt në një kryengritje të gjithë popullit shqiptar. Thirrjeve të Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare”, për të shkuar në Vlorë iu përgjigjën shumë vullnetarë nga anë të ndryshme të vendit e sidomos nga krahinat e afërta.

Luftimi popullor si një nga format e luftimit, mori zhvillim me pjesëmarrjen masive të popullit në luftën çlirimtare të Vlorës të vitit 1920 dhe të rrethinave të saj. Efektivi i forcave vullnetare erdhi duke u rritur me shpejtësi e në kohë me vullnetarë të ardhur nga të gjitha krahinat e vendit. Kryengritja mori zhvillim dhe pjesëmarrja e popullit, i cili u ngrit në këmbë për të fituar të drejta e tij, për liri dhe identitet. Forcat kryengritëse në fillim ishin të pak. Kjo dhe për vet karakterin e luftës, e cila nuk fillon menjëherë me pjesëmarrjen e popullit, për shkak të mundësive të kufizuara të rezervave njerëzore, por dhe të aparatit mobilizues në zonë e në vend. Zyrat e rekrutimit ushtarak mungonin në të gjithë krahinën e Vlorës dhe më gjerë. Por, me çlirimin e fshatrave një pas një, u krijua mundësia e shtimit të luftëtarëve.

Kryengritjen e armatosur që nisi popullsia patriotike e krahinës së Vlorës kundër pushtuesit italianë, u shndërrua shpejt në një kryengritje të gjithë popullit shqiptar. Thirrjeve të Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare”, për të shkuar në Vlorë iu përgjigjën shumë vullnetarë nga anë të ndryshme të vendit e sidomos nga krahinat e afërta. Kryengritësit u organizuan në çeta mbi bazë fshati, krahine e prefekturë duke vënë në komandë njerëzit me përvojë luftarake të provuar më parë. Nën drejtimin e Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare” u ngrit kështu një ushtri vullnetare kryengritëse, që arriti në 4.000 luftëtarë e përbërë kryesisht nga fshatarë. Por gjatë zhvillimit të kryengritjes kjo forcë arriti deri në 6.000 luftëtarë.

Një ndër masat përgatitore për daljen e vullnetarëve për luftë, ishte ngritja dhe organizimi i komiteteve të fshehta të “Mbrotjes Kombëtare”. Të tilla me shpejtësi u krijuan në Shqipërinë e Jugut e të Mesme, më

konkretisht në Vlorë, Tepelenë, Gjirokastrë, Përmet, Mallakastër, Fier, Berat, Skrapar, Pogradec, Korçë, Kolonjë, Tiranë, Elbasan, Shkodër etj. Të gjitha këto përgatitje u pasqyruan në shtypin përparimtar të kohës, si në organizimin e mitingjeve e të ndihmave të vijueshme, gjatë gjithë periudhës së luftës. Lëvizja në përkrahje të masave për luftë u zgjerua shumë gjatë muajve prill dhe maj të vitit 1920. Mitingje solitariteti dhe kërkesa e ultimatumë u bënë nga shumë qytete të vendit, ku pjesëmarrësit shprehnin gatishmërinë për ta ndihmuar nga ana materiale, por dhe për të shkuar vullnetarë në Vlorë.

Në mbështetje të luftës në mjaft krahina e zona të vendit u organizuan mitingje. Në Gjirokastrë, pjesëmarrësit u shprehën se “shqiptarët dje derdhën gjakun për të huaj, dinë të derdhin gjakun edhe për veten e tyre”. Ndërsa në mitingun e organizuar nga populli i Kolonjës, u theksua se “... të gjithë jemi gati të bëhemi theror për atdheun”. Në kujtimet e mësuesit elbasanas Ahmet Gashi, drejtues i bandës “Afërdita”, theksohet se për 10 ditë rresht shkua lagje më lagje e shtëpi më shtëpi të qytetit më bandën muzikore e me flamurin kombëtar për të mbledhur ndihma. Nuk mbeti shtëpi e dyqan pa na dhënë. Gjithsej u mbledhën 3000 napolona ar, të cilat ia dorëzuan Komisionit Qendror të Luftës së Vlorës. Përfaqësuesit e Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare” vunë në dijeni qeverinë e Tiranës për gatishmërinë e tyre dhe për fillimin kryengritjes. Kryeministri Sulejman Delvina dhe shumica e anëtarëve të qeverisë e pranuan gatishmërinë e tyre dhe i premtuan këtij Komiteti, kryesisht ndihma me materiale, por këto jo në rrugë zyrtare.

Konflikti i armatosur që po përgatitej në Vlorë shtrihej në tri zona të Labërisë si: në Vlorë, në Tepelenë dhe në Himarë. Kështu, konflikti merrte karakterin e një lufte lokale të banorëve të zonës së pushtuar nga imperialistët italianë. Hapjen e një konflikti më të madh shtetëror midis Italisë dhe

Shqipërisë, qeveria e Tiranës nuk e dëshironte. Ajo nuk e përballonte jo vetëm për mungesë forcash, por dhe për pozitën e vështirë në të cilin ndodhej vendi. Qeveria e Tiranës në vijimësi njoftonte në Vlorë se, nga Tirana, Elbasani, Peqini, Kavaja e të tjera, po rregjistroheshin e stërviteshin kryesisht luftëtarë, ndërsa në disa rrethe kishte filluar grumbullimi i ndihmave materiale si në Korçë, Berat, Tiranë, Shkodër e Gjirokastrë.

Natyrisht, peshën më të madhe të luftës në njerëz dhe në material e mbajti populli patriot i krahinës së Vlorës, në të cilën përfshihej atëhere dhe Tepelena, Kurveleshi e Himara. Kjo është e dukshme veçanërisht në fazën e parë të veprimeve luftarake. Me kohë në Kurvelesh ishte bërë një mbledhje, ku kishin marrë pjesë të gjithë fshatrat e Labërisë, për një lëvizje kundër forcave italiane që mbanin të pushtuar Vlorën. Kështu që “ditët e fundit mësuam sigurisht që lëvizja nisi”.

Sigurimin me ushqim të çetave të Kurveleshit dhe të Tepelenës, u vendos që çdo familje të jepte 3% të sasisë së kokeve të bagëtive të tyre. Sipas vendimit të Komisionit Ushtarak të Luftës

së Vlorës, fshatrat që kishin më pak se 20 luftëtarë do bashkonin me çetën e fshatit më të afërt. Në përfundim të mbledhjes u ngrit flamuri kombëtar dhe u deklarua se nuk njihej asnjë qeveri dhe se nuk pranohej të paguheshin taksat e detyrimet e vendosura nga qeveri në shërbim të pushtuesit. Çdo fshat ngriti një komision me 5-7 veta për sigurimin dhe administrimin e furnizimeve për çetat.

Luftimet për marrjen e garnizonit të Tepelenës vazhduan për dy javë, sepse trupat italiane deri dy batalioneve të këmbësorisë dhe një bateri artilerie, në pamundësi t’u qëndronin forcave kryengritëse në terren të hapur, u futën në Kalanë e qytetit. Forca kryengritëse bllokuan furnizimet përfshi furnizimin me ujë. Çetat e Kurveleshit (Golemit, Picarit, Lekdushit, Progonatit dhe Kolonjës) ishin përhapur nga ana e rrëzës së kodrave dhe sulmonin në drejtim të kalasë nga perëndimi e jugu. Më 21 qershor 1920 garnizoni u dorëzua.

Gazetari Italian Gustavo Tralio do të shkruante “... Tepelena, qytezë e vogël, e struktur në një kodër dhe e rrethuar nga mbeturinat e kështjellës së



Ali Pashës, u pushtua nga kryengritësit, të cilët përparuan gjatë kodrave. Këtë natë kemi dëgjuar topat që gumëzhijnë. Qyteti rronte prej disa netësh në ethe të vazhdueshme, sot në mëngjes u zgjua me zhurmën e zakonshme, duke pllakosur zija nëpër rrugë”. Ndërsa një gazetë tjetër italiane do të shkruante: “po jetojmë orë të tmerrshme. Të ngjethet mishi nga pamja e tmerruar e qytetit (Tepelene). Disa thonë se kryengritësit janë 5.000, të tjerë thonë 10.000, po asgjë s’dihet e saktë. Është e pamundur të vërtetosh shumën e saktë të humbjeve tona”.

Vullnetarë nga krahina të tjera të vendit dhe ndihma materiale arritën në fazën e dytë të luftimeve, në kohën e rrethimit të ushtrisë italiane në qytetin e Vlorës. “... rreth 5-6.000 shqiptarë rrethuan qytetin, por reagimi i trupave ishte i fort dhe efikas. Situata nga dita në ditë po merrte përmasat e një lufte





kombëtare për çlirimin e Shqipërisë...”. Vullnetarë dhe ndihma të tjera erdhën jo vetëm nga krahinat e afërta si: Berati e Gjirokastra, por edhe nga Korça, Elbasani, Durrësi e Tirana etj. Kontribut të shquar dhanë në Luftën e Vlorës në vitin 1920 dhe Mallakastra, Gjorokas-tra, Përmeti, Skrapari, Devolli, si dhe çetat e Çamërisë me Muharrem Rushitin dhe Alush Takën, çeta e Tiranës me Said Toptanin, si dhe çeta e Himarës me Nase Labin e Naqe Konomin, etj. Midis fazës së parë dhe të dytë erdhën ndihma vullnetare nga krahina Mallakastrës etj. Vullnetarë nga Tirana erdhën 200 luftëtarë, të cilët megjithëse nuk muarën pjesë aktive në luftë, por për moralin ishin shumë të vlefshëm. Në luftë erdhën edhe luftëtarë nga fshatrat e Bregdetit, si nga Vunoj e Himara, si edhe nga Borshi.

Fitoret e para qenë inkurajuese për forcat kryengritëse dhe shërbyen si nxitje për veprimtari më të vrullshme të komiteteve të ngritura në krahinat e tjera të vendit. Më tepër se 1000 vullnetarë u nisën për në front nga rrethet e Tiranës, Elbasanit, Beratit, Durrësit, Fierit, Korçës, Përmetit e Gjirokastrës. U mbledhën ndihma të shumta në të holla, veshje, sende ushqimore e armatime. Në front shkuan qindra vullnetarë të rinj nga të gjitha krahinat e vendit. Kështu, nga Gjirokastra, Korça e Çamëria mbritën 700 vullnetarë. Çetat e Skraparit me 300 luftëtarë, të udhëhquar nga Riza Cerova e Muço Kapinova, mbritën në Vlorë e në Tepelenë.

Lufta e Vlorës, si luftë çlirimtare, gjeti përkrahje edhe në qarqet përparimtare jashtë vendit. Ajo u mbështet nga shqiptarët me banim në Zvicër, Francë, SHBA e kudo. Në mbështetje të kësaj lufte mjaft bashkatdhetarë nga SHBA, pas thirrjes që bëri Kongresi i Lushnjës

në janar 1920, si dhe porosive që dha At Fan Noli në atë kohë, u nisën për në Vlorë. Thëksojmë, se në shtypin e kohës dhe veçanërisht në “Albania” është bërë një punë e madhe për të evidentuar dhe dokumentuar punën e aktivitetin e shqiptarëve në SHBA. Mjaft atdhetarë nga SHBA-ja dhe nga Kanada me thirrjen e bërë nga Kongresi, mbritën në Durrës më 4 prill të vitit 1920. Këtë e dokumenton Reis Iljaz Golemi në librin e tij “Simbol i Kombit”. Bashkë me këta vullnetarë, erdhi Banda Muzikore “Vatra”, me në krye kompozitorin, Prof. Thoma Nashi, i cili kompozoi dhe këngën “Vlora-Vlora”, me tekst të poetit Ali Asllani, Vullnetarët e ardhur nga SHBA-ja, nuk ishin të pak, por i kaluan mbi 500 luftëtarë në ndihmë të gjendjes së rëndë të atdheut, si dhe të pushtimit të Vlorës prej forcave ushtarake italiane.

Në Fazën e Dytë të luftimeve kundër pushtuesit italian, në mes të qershorit, Komandanti i Fuqive Vetëdashëse, u caktua Qazim Koculi. Betejat e Drashovicës, e Vreshtave të Mëdha, e Kalasë së Kaninës, e qafave të Vlorës, të Bestrovës, të Kuzumbabasë, dëshmuar dukshëm për trimërinë dhe heroizmin e vullnetarëve shqiptarëve për lirinë e atdheut të tyre.

Për këtë heroizëm të shfaqur dukshëm në luftë, Halim Xhelo në gazetën “Politika” të kohës do të shkruante: “... në brigjet e Vlorës e të Kaninës binin dëshmorë për liri dhe në fushat e Koplikut, në Shkodër, në malet e Dibrës luftonin vëllezërit tanë të veriut kundër sllavit po për këtë qëllim, që të shpëtonin atdheun. Viti 1920 është viti më i shënuar në përlindjen tonë, se pas Kastriotit ishte hera e parë që shqiptarët të bashkuar nën dyngjyrëshin (kuq e zi), luftonin krah për krah kundër të



huajve. Pra, nëse pati Greqia e moçme një Spartë dhe një Thermopile, Shqipëria e Re ka një Labëri dhe Qafën e Koçiut”.

Fshatrat përreth qytetit të Vlorës u shkatërruan nga bombardimet e kundërmësymjes 18 qershorit. Të indinjuar nga këto veprime barbare dhe duke pasur besim në fitoren përfundimtare, nga mbarë vendi, u shtuan ndihmat morale, ekonomike, financiare e ushtarake. Në korispodencën e qeverisë së Tiranës lexojmë se Elbasani e Pogradeci dërguan 83 arka me municion, Gramshi 150.000 fishekë etj. Më 3 korrik 1920, prefektura e Tiranës, njofton ministrinë e Punëve të Brendshme, se duke marrë parasysh dhe duke kuptuar rëndësinë që ka Vlora, mbrëmë në ora 6 Komisioni Ushtarak i formuar prej Major Ismail Haki Tatëzati, Kasem Sejdi Elbasanit, Kapedan Ferd Frashëri, nëntoger Azis Çami dhe doktor Sezai Çomo, u nisën për në Vlorë.

Më 13 korrik 1920, në Drashovicë përfaqësues të ardhur nga të gjitha krahinat e vendit formuan shoqërinë panshqiptare “Përlindja Kombëtare”. Nismëtarë të kësaj shoqërie ishin Seit bej Toptani, Xhemal Elbasani, Tahir Hoxha, Isa Çakërri, Halim Xhelo, Harilla Koleka, Ago Shero, Leonidha Milo e Gani Aliko. Qëllimi i kësaj

“Mbrotjtja Kombëtare”, vazhdimisht nëpërmjet të deleguarti të saj, interesohet për të gjitha problemet e situatës luftarake në krahinën e Vlorës. Në vijimësi qeveria tregoi kujdes të matur. Në një dokument thuhet: “Municion nga ato të armëve të Austrisë e të Turqisë me shpejti asht porositë në Shkodër, Korçë e tjera vise. Nga Tirana, Elbasani, Peqini, Kavaja, Shijaku, Kruja dhe nga Mati e Dibra, janë tue u përgatitë vullnetarë për me ardhë në ndihmë të Vlorës”.

Komisioni dhe prefektura në Drashovicë merreshin me punë të luftës, me përgatitje për çdo problem dhe me komisione të ndryshme të krahinave të tjera si në Berat, Fier, Lushnje, Gjirokastrë. Rugën për në Tiranë e kishim të çelur dhe shkonin përherë komisione. Nga qeveria ishte përfaqësues në Vlorë, ministri paprotofol Spiro J. Koleka, tek i cili komisioni kishte besim të madh.

Qeveria e Tiranës u angazhua dhe i kushtoi një vëmendje të veçantë kësaj lufte. Kështu në mjaft qarkore të Ministrisë së Punëve të Brendshme bëhet fjalë për Luftën e Vlorës dhe për rëndësinë që kishte ajo për vendin. Nëpërmjet një urdhëri telefonik MPB, i dërgon Eshref Frashërit në Elbasan, nisjen e municionit austriak për në Vlorë, ku thekson, se të nisurit e këtij municioni duhet ba

luftën që zhvillohen në Vlorë kundër pushtuesve italinaë theksohej “të përpigemi me çdo mënyrë që të bahen ndihma për këtë qëllim e të çohen atje një orë e ma parë”.

Në një letër dërguar komisionit të vullnetarëve të Elbasanit, lidhur me sukseset dhe moralin e lartë të luftëtarëve në Vlorë theksohet: është e pabesueshme se një grusht njerëzish luftojnë më një mbretëri të madhe, duke e nxjerrë nga pikat e fortifikuara... 5 aeroplanë të rrëzuar dhe një autobлиндë të dëmtuar. Morali dhe kuraja e ushtarëve e ma tepër e vlonjatëve dhe e kurveleshasve nuk mund të rrëfehët.

Prefektura e Elbasanit njoftonte MPB mbi vullnetarët dhe mjetet materiale dërguar në Vlorë: tue kuptue rëndësinë që ka Vlora për jetën indipedente të Atdheut tonë, gjer tashti kanë shkue afër 400 vetë vullnetarë, me gjithë një trupë shëndetësie... Gjithashtu prefektura e Elbasanit njoftonte se, nga Gramshi janë dërguar për në Vlorë municion, ku 10 kafshë janë të ngarkuara me 15.000 fishekë... Më 23 korrik 1920 MPB njoftonte prefekturën e Vlorës se Ushtria e Shijakut u nis. Prej Tiranës prapë po nisen vullnetarë.

Për mjekimin e të plagosurve, të cilët ishin të shumtë, shërbente spitali ushtarak i Kotës. Aty u grumbulluan të gjithë të plagosurit. Doktor shërbente Sezai Çomo nga Libohova, i cili sapo kishte mbaruar shkollën si nevrolog. Ai punoi në Drashovicë qysh në ditët e para të luftës. Ky u caktua drejtor i spitalit, ish djalë i ri 26 vjeç por dinamik, trim dhe agjikator i palodhur në të plagosur e në popull. Me të kishte ardhur edhe farmacisti Surja Libohova. Këta mbledhën ato pak vegla dhe barna që mundën të shpëtonin në Kotë. Këta të dy morën edhe doktorët italianë që ishin zënë robër dhe ngritën spitalin, filluan operacionet e atyre që kishin nevojë e mjekimet për ata që ishin më lehtë.

Pjesëmarrës në Luftën e Vlorës ishin dhe mjaft ushtarakë. Këta ndikuan në mobilizimin e njerëzve, me gjithë vështirësitë e shumta si mungesa e theksuar e rugëve dhe mjeteve të transportit, vështirësi në furnizimin me armë dhe municione. Më tej u ndije mungesa në fuqinë dhe në dobinë e zjarrit, pra të pajisjes me armatim, përballë një kundërshtari të armatosur me mjete më të mira të kohës. Të gjitha këto u kompesuan nga epërsia e pjesëmarrjes së masave popullore në këtë luftë kryengritëse, por dhe nga udhëhëqja e ushtarakëve shqiptarë, si dhe nga njohja e mirë e terrenit.



shoqërie ishte të ngrinte në këmbë gjithë djelmërinë shqiptare. Në informacionin e Komitetit të “Mbrotjtjes Kombëtare” të Vlorës, dërguar komisionit të Elbasanit, mbi sukseset e luftëtarëve shqiptarë kundër forcave italiane të pushtimit, theksohet se të gjitha krahinat janë në dorën tonë me përfundim të Kalasë së Kaninës dhe të qytetit të Vlorës. Mbrëmë u ramë këtyre, por lamë shumë të vrarë dhe të plagosur e nuk i morëm dot. Ju lutemi të na ndihmoni shpejt.

Në mënyrë të tërthortë, qeveria e Tiranës, për të ndihmuar Komitetin

me qeti. Në një tjetër dokument teksohet se Nënprefektura e Shijakut nisi sonte 89 burra nën kryesinë e Mustafa bej Ndroqit ... për Vlorë. Më tej, prefektura e Gjirokastrës njoftonte se kishte nisur për në Vlorë disa forca gjendarmërie, për të mbajtur rregull dhe qetësi. Ajo theksonte se nën komandën e toger z. Zilal dërguam 100 gjendarmë, ku theksonte për të mos u futur në luftë, por t'i përdorin për rregull dhe qetësi...

Ndërsa në një qarkore po të MPB drejtuar prefekturave dhe nënprefekturave të vendit për të ndihmuar

Pentagoni do shtojë përdorimin e dronëve

Numri i avionëve me telekomandë që përdorin Shtetet e Bashkuara në mbarë botën do të rritet me afro 50 përqind. Plani në fjalë kërkon shtimin e numrit të fluturimeve ditore të këtyre avionëve nga rreth 60 deri në 90, tha të hënën zëdhënësi i Pentagonit, Jeff Davis. Avionët me telekomandë mbledhin të dhëna nga pikat e nxehta në mbarë botën dhe kanë aftësi luftarake, që është edhe pjesa më e debatueshme. Anës luftarake të avionëve me telekomandë i është vënë ndjeshëm një theks më i madh gjatë administratës së presidentit Barack Obama. Zëdhënësi i Pentagonit tha se shtimi i fluturimeve me këta avionë do të ketë nevojë për më shumë analistë që përpunojnë informacionet e zbulimit. Zoti Davis tha se pjesa më e madhe e fluturimeve me telekomandë realizohet nga Forca Ajrore, por plani i ri do ta zgjerojë programin edhe për degë të tjera brenda Pentagonit deri tek kontraktorët që punojnë për qeverinë. Forca Ajrore, tha zëdhënësi i Pentagonit Jeff Davis, do të vazhdojë të kryejë rreth 60 fluturime të tilla në ditë, ndërkohë që këmbësoria do të kontribuojë me 10 deri 20 fluturime. Komanda e Operacioneve Speciale do të kryejë rreth 10 misione me avionë me telekomandë. Po ashtu, tha ai, do të punësohen kontraktorë për qeverinë për të kryer deri në 10 fluturime në ditë, por asnjë nga këta avionë nuk do të jetë i pajisur me armatim. Shtetet e Bashkuara kanë kryer operacione me avionë të telekomanduar në vende si Pakistani, Afganistani, Iraku, Jemeni dhe Somalia, për të vënë në shënjestër udhëheqës terroristë. Gjatë kohës së luftrave në Irak dhe Afganistan, kërkesat e komandantëve për avionë të telekomanduar u rrit mjaft, sa që Pentagoni e ka patur të vështirë të plotësojë kërkesast. Një anketë në fillim të vitit e realizuar nga "Associated Press", gjeti se shumica e amerikanëve, rreth 60 përqind, mbështesin përdorimin e këtyre avionëve për të vënë në shënjestër terroristët. Anketa tregoi se vetëm 13 përqind e amerikanëve u shprehën kundër, ndërkohë që 24 përqind ishin të painteresuar.

Sh.Kërçelli



Avionët me telekomandë mbledhin të dhëna nga pikat e nxehta në mbarë botën dhe kanë aftësi luftarake, që është edhe pjesa më e debatueshme

